

1 E premte, 22 mars 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Konferencë për Ecurinë e Çështjes]

4 [I akuzuari Januzi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 [Të akuzuarit hynë në sallën e gjyqit]

7 --- Seanca fillon në orën 14.31

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita, mirë se erdhët ju
9 që jeni të pranishëm në sallën e gjyqit dhe ju që jeni jashtë
10 sallës së gjyqit.

11 Sekretare e Gjykatës, paraqisni lëndën.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
13 Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2023-10, Prokurori i
14 Specializuar kundër Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi
15 Shalës.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

17 U lutem palëve që të prezantohen, duke filluar me
18 Prokurorinë.

19 Znj. Prokurore, fjala është për ju.

20 ZNJ. SHAHBUDDIN: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
21 Gjykatës. Nga ana e Prokurorisë është Eleonore Coeuret, që
22 është specialiste përgjegjëse për nxjerrjen e provave; Joshua
23 Hafetz, Prokuror; Line Pedersen, menaxhere e lëndës; dhe unë
24 Tazneen Shahabuddin, Prokurore.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

1 I drejtohem Mbrojtjes.

2 Mbrojtja e z. Januzi, ju lutem.

3 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Unë jam -- unë
4 kam këtu z. Huw Bowden, që është bashkëmbrojtës, z. Januzi
5 është i pranishëm përmes videolidhjes, po ashtu dhe unë jam
6 Jonathan Rees, avokati i z. Januzi.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

8 Po, vërej për procesverbal që ju po ndiqni përmes
9 videolidhjes.

10 I drejtohem Mbrojtjes së z. Bahtijari.

11 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Mirëdita, i
12 nderuar Gjykatës, dhe ju që jeni të pranishëm në sallën e
13 gjyqit. Unë jam Felicity Gerry, avokate e z. Bahtijari, i cili
14 besoj se është i pranishëm fizikisht në sallën e gjyqit,
15 ndërsa unë po ju ndjek përmes videolidhjes.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Vërej po që
17 z. Bahtijari është i pranishëm në sallën e gjyqit për ecuri të
18 çështjes gjyqësore.

19 Tani Mbrojtja e z. Shala.

20 Z. CADMAN: [Përkthim] Mirëdita, unë jam Toby Cadman,
21 avokat i z. Haxhi Shala, që është i pranishëm në sallën e
22 gjyqit. Kam të pranishëm këtu z. John Cubbon bashkëmbrojtës;
23 dhe Admir Berisha, hetues.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

25 I drejtohem Zyrës Administrative tani.

1 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.
2 Mirëdita, të nderuar kolegë. Unë jam Jonas Nilsson,
3 Zëvendësadministrator, dhe përfaqësoj Zyrën Administrative.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Unë jam Nicolas Guillou,
5 Gjykatësi i Procedurës Paraprake në këtë çështje gjyqësore.

6 Më 14 mars, planifikova Konferencën e pestë për Ecurinë e
7 kësaj Çështje gjyqësore. Synimi im është të shohim çfarë
8 ecurie ka pasur kjo çështje dhe të organizojmë më tej
9 shkëmbimet, komunikimet me palët dhe të organizojmë një
10 përgatitje sa më të shpejtë për gjykim.

11 Veçanërisht, duam që të diskutojmë: Pikësëpari, çështjen
12 e financimit nga ekipet e Mbrojtjes që ka dalë nga të gjitha
13 ekipet e Mbrojtjes përmes parashtrimeve me shkrim; dua të
14 diskutojmë për nxjerrjen e materialeve provuese; ecurinë e
15 hetimeve nga ana e Prokurorisë; pikat ku palët pajtohen, pikat
16 juridike dhe faktike; statusin e hetimeve nga ana e Mbrojtjes;
17 transmetimin e dosjes gjyqësore dhe kur mendojnë palët që të
18 jenë gati për fillimin e gjykimit; dhe në fund, aspekte të
19 tjera që vetë palët mund të kenë dëshirë që të parashtrojnë.

20 Falënderoj palët për parashtrimet e tyre përpara se të
21 fillonim këtë konferencë për Ecurinë e Çështjes gjyqësore dhe
22 si zakonisht ftoj palët, Zyrën Administrative të jenë sa më
23 konciz për secilën nga pikat në rendin e ditës që ta marrim
24 radhë pas radhe dhe si zakonisht ne duhet të kalojmë në seancë
25 private në qoftë se duhet të diskutojmë çështje konfidenciale.

1 Përpara se të flasim për financimin e ekipeve të
2 Mbrojtjes, vërej se Mbrojtja e Bahtijarit ka theksuar nevojën
3 për një kontroll mjekësor të të akuzuarit. Mbrojtja e
4 Bahtijarit thotë se z. Bahtijari ka shumë probleme
5 shëndetësore që kërkojnë një kontroll nga një specialist në
6 katër kontekste: Aftësia e tij për të nënshtruar [Sipas
7 përkthimit]; gjendja e tij për të qëndruar gjatë gjykimit;
8 aftësia e tij konjitive gjatë gjithë kohës të shkeljeve të
9 pretenduara; dhe shëndeti i tij pas transferimit në objektin e
10 paraburgimit.

11 Nuk dua që të diskutojmë detalet e situatës shëndetësore
12 të të akuzuarit se kjo është çështje private, megjithatë ftoj
13 Mbrojtjen e Bahtijarit të dorëzojë një parashtrim me shkrim ex
14 parte ku të kërkojnë një vlerësim për kontroll shëndetësor dhe
15 të na specifikojnë çfarë problemesh shëndetësore konkrete ka i
16 akuzuari në mënyrë që të gjejnë një mjek specialist që ka edhe
17 kualifikimet e duhura; llojin e vlerësimit që duhet bërë,
18 gjegjësisht nëse kontrolli duhet bërë për situatën e z.
19 Bahtijari pas transferimit në objektin e paraburgimit të
20 Dhomave të Specializuara dhe situatën apo gjendjen e tij
21 shëndetësore gjatë kohës që pretendohet se ka ndodhur vepra
22 penale apo për të dyja këto situata.

23 I falënderoj paraprakisht Mbrojtjen e Bahtijarit për
24 dorëzimin e kërkesës.

25 Të flasim tani për çështjen e financimit që e kanë

1 ngritur të gjitha ekipet e Mbrojtjes përpara se të fillonte
2 Konferenca për Ecurinë e Çështjes.

3 Duke marrë parasysh që bëmë në Konferencën e fundit për
4 Çështjen gjyqësore, i kam kërkuar Zyrës Administrative të më
5 përditësonte çdo javë lidhur me situatën. Vërej që ekipet e
6 Mbrojtjes e kanë ngritur këtë problem në parashtrimet e tyre.

7 Mbrojtja e Januzit thotë që nuk ka pasur asnjë përmirësim
8 të situatës qysh prej Konferencës së katërt për këtë Çështje
9 Gjyqësore. Ka folur edhe për amendamentet që i janë bërë
10 regjimit juridik, më falni, regjimit të ndihmës juridike të
11 Dhomave të Specializuara edhe thotë që duhet bërë -- duhet të
12 ketë kundërshtime juridike si mjeti i vetëm juridik i mundshëm
13 në këtë rast.

14 Mbrojtja e Bajtjarit ka thënë se z. Bahtijari ka marrë
15 formularët përkatës për të kërkuar ndihmën juridike sipas
16 sistemit të Dhomave të Specializuara dhe i ka filluar t'i
17 plotësojë. Megjithatë, sipas Mbrojtjes së Bahtijarit kjo është
18 vështirë për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.

19 Mbrojtja e Bahtijarit ka bërë dhe kërkesë për mundësi
20 hetimore unike për të përfituar burime financiare në mënyrë që
21 të krijojnë një ekip për të hetuar dhe të marrë materiale
22 nevojiten për të plotësuar formularët përkatës.

23 Ju rikujtoj se rregulla 99, që është për mundësi hetimore
24 unike ka të bëjë me disponueshmërinë e një ligji, më falni,
25 mundësi hetimore që është një mundësi unike për të siguruar

1 prova që mund të mos jenë më pas të disponueshme në gjykim.
2 Dhe prandaj nuk është baza e përshtatshme ligjore për të
3 kërkuar ndihmë juridike me këtë rregull përpara Dhomave të
4 Specializuara.

5 Sidoqoftë, unë ju propozoj kështu: Sa i takon situatës
6 specifike të z. Bahtijari siç na e ka parashtruar avokati i
7 tij, unë them që z. Bahtijari ta marrë ndihmën ose nga një
8 përfaqësues i Zyrës për Mbrojtjen ose të ketë një avokat
9 kujdestar në gjuhë shqipe vetëm për ta ndihmuar z. Bahtijari
10 që të plotësojë formularët për ndihmë juridike. Personi që do
11 ta ndihmojë z. Bahtijari do të komunikojë anëtarët e tij të
12 familjes dhe persona të tjerë përgjegjës ose me institucionet
13 përkatëse në mënyrë që të marrë dokumentet, informacionet, në
14 mënyrën që ta zhbllokojmë këtë ngërç që kemi aktualisht.

15 Do të doja që Zyra Administrative dhe Mbrojtja e
16 Bahtijarit të bëjnë parashtrim me gojë për propozimin që sapo
17 bëra unë.

18 Gjithashtu, Mbrojtja e Shalës ka thënë po ashtu që
19 situata e financimit ka pasur ndikim në punën e tyre.

20 Tani do të doja që secili nga ekipet e Mbrojtjes të më
21 flasë për situatën e financimit, konkretisht: A kanë kërkuar
22 apo synojnë të kërkojnë ndihmë juridike nga Dhomat e
23 Specializuara, nëse po në çfarë faze është kërkesa e tyre;
24 gjithashtu nëse kanë deponuar një apelim kundër vendimit që ka
25 nxjerrë Ministria e Drejtësisë së Kosovës për pagesë, apo për

1 faktin që ka nxjerrë vendim që ka refuzuar rishqyrtimin e
2 shumës së financimit.

3 Po filloj me z. Rees. Z. Rees, fjala është për ju.

4 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Dua të flas
5 fillimisht për skemën e Ministrisë së Drejtësisë, të nderuar
6 Gjykatës.

7 Kërkesa jonë për financim u refuzua nga një vendim që
8 ishte krejt i paarsyeshëm. Shuma që na është ofruar nuk ka
9 asnjë mundësi që të jetë e arsyeshme dhe të jetë e pranueshme.
10 Kjo është e vërteta. Ne e apeluam ofertën që na bënë dhe na u
11 rrëzua apelimi dhe nuk pati kurrfarë arsyetimi në vendimin e
12 tyre.

13 E vetmja masë që mund të marrim ne është që të kërkojmë
14 një rishikim administrativ të vendimit të tyre dhe jemi
15 aktualisht duke e përgatitur, teksa flasim, këtë kërkesë.

16 Sa i takon Zyres Administrative, i nderuar Gjykatës, ju
17 thatë që në Konferencën e Katërt ju kërkuat nga Zyra
18 Administrative të ofronte ndihmën e vet në mënyrë që të
19 zgjidhet çështja e këtij financimi -- ky ngërç që është
20 krijuar. Ata e bënë edhe më keq situatën. Nëntë ditë pas
21 Konferencës së nëntë, Zyra Administrative në mënyrë të
22 njëanshme, pa kurrfarë konsultimi, pa asnjë paralajmërim, pa
23 bërë një negociatë të vetme, pa u a thënë edhe ju Gjykatës,
24 gjatë Konferencës së katërt për Ecurinë e Çështjes, deklaruan
25 që do të ketë reduktime në buxhet në skemën juridike të

1 Dhomave të Specializuara që prek 60 deri në 75 për qind
2 financimin për Mbrojtjen. Kjo është një shifër e papranueshme,
3 e paprecedentë. Të reduktohet me 60 deri në 75 për qind
4 buxheti, është e padëgjuar ndonjëherë.

5 Ky është një sulm kundër nesh dhe cenon të drejtat e z.
6 Januzi sipas nenit 6, sipas të cilit i duhet ofruar mjetet e
7 përshtatshme për të përgatitur Mbrojtjet e veta dhe sigurisht
8 për të respektuar parimin e armëve të barabarta, ku kërkohet
9 sistemi i ndihmës juridike t'i japi mundësinë avokatit të
10 paraqesë çështjen e z. Januzi përpara Dhomave të Specializuara
11 dhe të ketë të gjitha kushtet e nevojshme për të qenë në
12 kushte të barabarta me ZPS-në. Ne nuk jemi në kushte të
13 barabarta më, edhe më keq shkon situata për faktin që nuk u bë
14 asnjë konsultim përpara se të bëheshin këto reduktime.

15 Një shkurtim buxheti me 60 deri 75 për qind në buxhetin e
16 ZPS-së a është marrë, a është vendosur në të njëjtën kohë?
17 Buxheti për hetimin e kësaj çështje gjyqësore nuk ka qenë
18 objekt financimi. Si është situata e kolegëve në të djathtën
19 tuaj, i nderuar Gjykatës? Ata që përfaqësojnë Prokurorin e
20 Specializuar, a u është reduktuar edhe atyre buxheti me 60
21 deri në 75 për qind në mënyrë të njëanshme? A u është
22 shkurtuar atyre, a u është reduktuar atyre pagesa? Po
23 personelit të Zyrës Administrative, po ata kanë qenë objekt
24 shkurtimesh buxheti me 60 deri në 75 për qind? Përkthyesve në
25 sallën e gjyqit, siç thuhet për përkthyesit tanë që punojnë

1 për Mbrojtjen, po përkthyesve atyre u është shkurtuar buxheti,
2 u është shkurtuar pagesa me 60 deri 75 për qind? Po ty vetë, i
3 nderuar Gjykatës? Pagesa juaj të është reduktuar pagesa me 60
4 deri në 75 për qind?

5 Pra, siç e kuptoj unë kjo ka qenë një synim i qëllimshëm
6 i Dhomave të Specializuara të Kosovës në vend që të
7 respektonin standardet më të larta të drejtësisë penale
8 ndërkombëtare të sistemit të drejtësisë penale ndërkombëtare,
9 por këto ndryshime që janë bërë së fundmi për ndihmën juridike
10 nga Zyra Administrative fatkeqësisht nuk mund të na -- nuk
11 mundeshin më larg se standardet që ekzistojnë. Nuk i
12 respektojnë aspak standardet që ekzistojnë.

13 Unë ju -- unë e vlerësoj që ju po largoheni, i nderuar
14 Gjykatës, dhe do të shkoni të punoni në Gjykatën Penale
15 Ndërkombëtare në të ardhmen e afërt, dhe unë ju përgëzoj për
16 këtë.

17 Skema për ndihmën juridike që ekziston tani e rishikuar
18 në Dhomat e Specializuara të Kosovës është 30 për qind dhe
19 vetëm 10 për qind e financimit është në dispozicion për
20 Gjykatën Penale Ndërkombëtare, dhe përbën vetëm 10 për qind të
21 Gjykatës ku do të punoni ju për procese të ngjashme.

22 Jo që kjo është tërësisht e pajustificuar, një shkurtim i
23 tillë buxheti, por Zyra Administrative as nuk është përpjekur
24 ta justifikojë këtë ndryshim. Nuk është përpjekur minimalisht
25 të na japë një shpjegim, të na thonë pse u bënë këto

1 shkurtime. E jo më pastaj të ishte konsultuar përpara se t'i
2 fuste në fuqi ndryshime të tilla.

3 Për Kategorinë 3, financimi që propozohet nuk paguan më
4 shumë se një orë e gjysëm punë në ditë për çështjen e z.
5 Januzi dhe këtu përfshihet ekipi i tij i avokatit
6 bashkëmbrojtësit dhe një ekip ndihmës në ekip. Me atë pagesë
7 që po na afrohet ky është maksimumi i kohës që mund të
8 shpenzojmë ne për çështjen e z. Januzi. Pra, një orë e gjysëm
9 në një ditë. Atëherë, si do të jemi në gjendje ne të fillojmë
10 një gjykim kur ne mund të punojmë vetëm një orë e gjysmë në
11 ditë. Kjo është e paimagjinueshme dhe askush nga Zyra
12 Administrative nuk është përpjekur minimalisht të na shpjegojë
13 si mendojnë ata se mund të na ndihmojë ne kjo shifër për të
14 kryer punën tonë dhe si mundet kjo shifër e përshtatshme dhe e
15 arsyeshme për punën e Mbrojtjes.

16 Pasi na thatë që të kërkonim ndihmë nga Zyra
17 Administrative, i nderuar Gjykatës, dhe unë e di që ju këtë e
18 bëtë me shpresën që ne do të arrinim të kishim një marrëveshje
19 konstruktive, dhe unë jam i bindur që ju, i nderuar Gjykatës,
20 as ju nuk e kishit imagjinuar rezultatin që në fakt rezultati
21 është që ata nëntë ditë më pas në mënyrë të njëanshme na
22 sulmuan apo na cenuan, më saktë, me këtë skemën e re të
23 ndihmës juridike. Sidoqoftë ne do të kishim shpresuar që do të
24 gjenim një zgjidhje miqësore, konstruktive që ta zgjidhnim
25 këtë ngërç.

1 I kërkuam Zyrës Administrative nëse kanë bërë ndonjë
2 vlerësim, nëse z. Januzi është objekt i ndihmës juridike. Nuk
3 e bënë këtë gjë.

4 U kërkuam të na thonë nëse e kanë kategorizuar këtë
5 çështje në mënyra provizore për të pasur një ide të
6 përgjithshme. A është Kategoria 1, 2 apo 3 kjo çështje
7 gjyqësore. Nuk pranuan fare të fillonim një diskutim të tillë.

8 Po ashtu u kërkuam, në mënyrë që të gjenim një zgjidhje
9 sa më të shpejtë të problemit nëse e lemë mënjanë vështirësitë
10 që kemi tani me skemën e Ministrisë së Drejtësisë, por nëse
11 Zyra Administrative do të zbatonte Rregulloren e Ndihmës
12 Juridike siç e zbatuan kur ngritën akuzat për z. Januzi edhe
13 ishte ende në fuqi kjo kur kam qenë unë në Konferencën e
14 katërt për Ecurinë e Çështjes gjyqësore dhe ku z. Nilsson
15 mbajti edhe një fjalë në Konferencën e katërt për Ecurinë e
16 Çështjes gjyqësore.

17 Zyra Administrative edhe në këtë rast refuzoi të fillonte
18 ndonjë komunikim konstruktiv për t'i zgjidhur këto çështje.
19 Dhe na ka lënë në një situatë ku duhet të diskutojmë nga
20 pikëpamja ligjore Ministrinë e Drejtësisë edhe të marrim masa
21 juridike kundër Zyrës Administrative si zgjidhja e vetme që
22 kemi ne në mënyrë që të garantojmë që z. Januzi do të ketë një
23 gjykim të drejtë.

24 Ne kemi përcaktuar një listë kërkesash për t'ia u bërë me
25 dije Zyrës Administrative që do të na bëjë të mundur që të

1 përfundojmë parashtrimet tona për Dhomën Kushtetuese kundër
2 vendimit të Zyrës Administrative në mënyrë të tillë që të
3 përcaktohen nga kjo Dhomë ndryshmet e njëanshme nga Zyra
4 Administrative. Pyetje të cilat janë bërë deri tani është që:
5 Të gjitha komunikimet deri tani kanë ndodhur Zyrës
6 Administrative, dhomave -- Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës
7 dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Kemi kërkuar
8 gjithashtu edhe për arsye të tjera më të gjëra që kanë të
9 bëjmë me ndryshimet që lidhen me financimin e ndihmës
10 juridike. Po ashtu kemi pyetur se pse janë bërë ndryshime të
11 tilla kaq pranë nga momenti kur Ministria e Drejtësisë në
12 vetvete në Republikën e Kosovës ka vendosur që të bëhen
13 ndryshime të tilla. Megjithatë, këtë kërkesë e kemi bërë
14 *proprio moto* ose me propozim të Gjykatësit apo përmes një
15 organi të pavarur gjyqësor. Përderisa këto janë vetëm
16 origjinat e vetme të cilat mund të çojnë në ndryshimin e
17 direktivës ose udhëzimit administrativ së Dhomës së
18 administrove.

19 Gjithashtu, pyetëm se cilat janë propozimet si për sa i
20 takon ndryshimit të udhëzimeve për Mbrojtjen apo cilat janë
21 justifikimet të cilat kanë çuar në ndryshimet që përmenda më
22 sipër. Ne kemi thënë gjithashtu tarifatat të cilat janë
23 përcaktuar nga udhëzimet e mëparshme që kanë qenë udhëzimet që
24 ishin në fuqi herën e fundit që ju jam drejtuar, i nderuar
25 Gjykatës, pra në Konferencën e katërt për Ecurinë e Çështjes

1 ne kemi parashtruar me fakte që rregulloret ose udhëzimet e
2 rishikuara kanë çuar në shkurtimin e rreth 65 deri 70 për qind
3 të ndihmës juridike të parashikuar më herët. Kështu që kemi
4 kërkuar që të na jepnin shpjegimet se pse ka një ulje të
5 tillë, një diskutim të tillë të tarifave dhe të shumës të
6 ndihmës juridike brenda nëntë ditësh.

7 Gjithashtu kemi kërkuar që të përcaktohet se cilat janë
8 aspektet që janë marrë parasysh në regjim dhe në qoftë se janë
9 bërë studime krahasimore ndërmjet Gjykatave të tjera
10 ndërkombëtare, për shembull sikurse e përmenda më sipër çfarë
11 justifikimi është dhënë për sa i takon fondeve. Sepse sikurse
12 e thashë më përpara në rastin më të mirë fondet që kishin
13 Dhomat e Specializuara të Kosovës ishin 30 për qind e fondeve
14 që kishte Gjykata Ndërkombëtare Penale ose në rastin më në
15 normal 10 për qind.

16 Kemi kërkuar gjithashtu dhe kopje të korrespondencës sa i
17 takon ndryshimeve ndërmjet Zyrës Administrative dhe Ministrisë
18 së Drejtësisë së Kosovës. Po ashtu në qoftë se dëshiron që të
19 mbajnë një pjesë të kësaj korrespondence për veten e tyre,
20 duhet që të përcaktojnë në qoftë se ka ndodhur shkëmbim apo
21 jo. Cila ka qenë -- në çfarë datash ka ndodhur një
22 korrespondencë e tillë. Dhe në qoftë se përgjigja për këtë
23 pyetje është "jo" për shembull që nuk kemi pasur asnjë
24 korrespondencë ne kemi kërkuar që Zyra Administrative të mund
25 të na shpjegojë pak ko incidencën e kohës kur është nxjerrë

1 vendimi i Ministrisë së Drejtësisë krahasimisht me ndryshimet
2 e udhëzuesit nga Dhomat e Specializuara, që siç e thashë edhe
3 më përpara ka ndodhur vetëm nëntë ditë pas Konferencës së
4 katër për Ecurinë e Çështjes. Ndërkohë që ka pasur heshtje
5 tërësore lidhur me këto shkurtime.

6 Ne kemi theksuar që efekti i kombinuar për dy skemat që
7 secilin prej individëve që janë të akuzuar për pengimin e
8 drejtësisë përpara Dhomave të Specializuara të Kosovë ndërkohë
9 ekipet e Mbrojtjes janë të cenuara ndërkohë që ZPS-ja nuk ka
10 pësuar asgjë, asnjë lloj shkurtime dhe asnjë lloj problemi.
11 Pra, nuk ka fare shkurtime sa i takon hetimeve dhe nuk ka
12 shkurtime dhe sa i takon pagave që merr personeli i vet.
13 Ndërkohë, të akuzuarit që duhet që të mbrohen vetë në një
14 situatë të tillë të pabarabartë pra, përballë një Zyre
15 Prokurorie që ka shumë burime dhe shumë më tepër të ardhura
16 është një qëndrim të cenueshëm.

17 Kështu që në këto rrethana i nderuar Gjykatës, do ju
18 kërkoja që të udhëzonit Zyrën Administrative që të japë
19 përgjigje të hollësishme për secilin prej pyetjeve që përmenda
20 më sipër. Deri tani nuk ka dhënë asnjë përgjigje. Deri tani
21 nuk i kanë marrë fare parasysh këto kërkesa. Thjesht, kanë
22 shkurtuar për të thënë rregullore dhe udhëzimet për ndihmën
23 ligjore, ndihmën juridike falas janë këto që kemi botuar tani.
24 Është në dorën tuaj për të aplikuar, për të kërkuar ndihmë
25 juridike falas apo jo.

1 Kjo nuk është përgjigje për pyetjet tona. Nuk është
2 përgjigje shkurtime të cilat janë bërë të detyrueshme duke
3 shkelur të gjitha normat e sjelljes administrative dhe
4 ekzekutive. Dhe në shkelje të normave ndërkombëtare të cilat
5 kërkojnë që të organizohen konsultime ndërmjet organit që bën
6 propozimin për ndryshimet përkatëse dhe palët e tjera të cilat
7 ceken apo ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në mënyrë
8 të rëndë prej tyre.

9 Ne kërkojmë përgjigje për pyetjet që unë shtrova më herët
10 sepse ne do të ngremë argumente juridike për të ditur se si
11 është sjellë Zyra Administrative. Sipas nesh pra, ne
12 parashtrojmë që Zyra Administrative është sjellë në mënyrë të
13 paligjshme, dhe kjo është çështja, apo ky është parashtrimi që
14 do ju dërgojmë Dhomave Kushtetuese. I nderuar Gjykatës, do ju
15 kërkoja që ZPS-ja dhe palët e tjera të mund t'i përgjigjen në
16 mënyrë të hollësishme të gjitha këtyre pyetjeve që unë
17 përmenda më lartë. Këto janë pyetje të cilat janë dhënë me
18 hollësi në parashtrimet e dorëzuara. Sigurisht që Zyra
19 Administrative e ka pasur kohën në dispozicion për t'u
20 përgjigjur sa i takon korrespondencës dhe këto janë kërkesat
21 të cilat i kam bërë jo vetëm unë por edhe ekipet e tjera të
22 Mbrojtjes.

23 Po ashtu do ju kërkoja, i nderuar Gjykatës, që të
24 udhëzonit Zyrën Administrative që të përgjigjej deri në orën 5
25 pasdite të enjten, datë 28 mars. E kam fjalën për të enjten që

1 vjen.

2 Do të ishte mirë që këto përgjigjet të mund t'i merrni në
3 mënyrë të tillë që të dimë se çfarë do të bëjmë pastaj në
4 procesin tjetër të nxjerrjes së materialeve.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

6 Do i jap fjalën gjithashtu pak më vonë Zyrës
7 Administrative që t'i përgjigjet pyetjeve të ngritura, por së
8 pari dua që t'i jap fjalën ekipeve të tjera të Mbrojtjes, sa i
9 takon në veçanti nxjerrjes së informacionit të kërkuar për
10 çështjet që ngriti z. Rees.

11 Pa vonesë dua t'i jap fjalën doktor Gerry.

12 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Edhe unë dua
13 t'ju falënderoj për emërimin në Gjykatën Ndërkombëtare Penale.
14 Shpresoj të mos jeni nën presion që të përshpejtoni proceset
15 dhe procedurat këtu në mënyrë të tillë që të mos pengoheni të
16 vazhdoni me punë në Gjykatën Ndërkombëtare Penale.

17 Sigurisht që unë z. Rees e mbështes në parashtrimet e
18 veta në çdo gjë që ai ngriti. Nuk dëshiroj që të përsëris ato
19 çfarë tha z. Rees, por mospërsëritja ime nuk është se e ul
20 fuqinë e kërkesave që ne kemi.

21 Më lejoni në këtë kontekst që t'ju jap një vështrim të
22 përgjithshëm të pozicionit të përgjithshëm të z. Bahtijari, në
23 mënyrë të tillë që ta keni të plotë panoramën duke filluar me
24 Ministrinë e Drejtësisë. Në Ministrinë e Drejtësisë kërkesa
25 për financim është dërguar në janar. Është dërguar më shumë se

1 një herë dhe kërkesat janë injoruar plotësisht derisa u fut në
2 fuqi një ligj i ri me datë 2 shkurt, dhe Ministria e
3 Drejtësisë pastaj vendosi që ky ligj ishte ligji i zbatueshëm.
4 Financimet ishin diku nga 20 deri në 70.000 mijë në vartësi të
5 kompleksitetit të çështjes, me një ofertë prej 1000 euro, dhe
6 pra oferta në dispozicion ishte 1000 euro në muaj. Por kjo
7 shumë është e pamundur për të paguar mbrojtësin,
8 bashkëmbrojtësin, anëtarët e tjerë të ekipit, një asistent apo
9 persona të tjerë të cilët janë të nevojshëm për ekipet e
10 Mbrojtjes. Ne deri tani kemi bërë 225 parashtime të
11 protokolluara.

12 Ne e kemi kundërshtuar këtë ofertë. Sepse thamë,
13 faleminderit, për kaq, por kaq para nuk janë të mjaftueshme
14 për me. Jo vetëm kaq por në rastin e z. Bahtijari, ai ka
15 probleme shëndetësore, kjo është një çështje veçanërisht e
16 komplikuar. Z. Bahtijari jeton në fshat së bashku me
17 bashkëshorten e tij. Ai ka gjashtë fëmijë, njëri prej tyre
18 është ushtar në Kosovë. Ai është punëtor krahu. Dhe çdo ditë
19 ai futet në -- merr një kerr dhe shkon për ta çuar në
20 Prishtinë në mënyrë të tillë që të kërkojë punë atje.
21 Ndonjëherë, domethënë, nevoja është kaq e madhe sa ai mban të
22 gjithë familjen.

23 Është vajzat e tij rrinë në shtëpinë, nuk kanë asnjë të
24 ardhur. Ndërkohë që djemtë e tij, dy prej tyre nuk janë në
25 Kosovë, janë gjetkë, pra jetojnë në vende të tjera, duke

1 kërkuar punë atje sepse Kosova është një vend i varfër.

2 Ndërkohë që siç e thashë, një djalë e ka ushtar.

3 Dhe Ministria e Drejtësisë ta lë një person të tillë me
4 probleme të shumta përfshirë këtu probleme shëndetësore të
5 cilat i përmendët edhe ju, i nderuar Gjykatës, dhe një pjesë e
6 të cilave janë pjesë e dosjes që ju e keni, z. Gjykatës. Unë
7 kam qëndruar me të, e kam ndihmuar për shkak të marrëdhënies
8 që kam me të. Ne kemi marrëdhënie të mirë. Unë jam avokatja që
9 ai ka zgjedhur. Jam takuar me djalin e tij. Kam folur me
10 djalin tjetër dhe në ndërkohë kam shpenzuar 4000 euro nga
11 lekët e mia në mënyrë të tillë që të mbroj z. Bahtijari.

12 Zyra Administrative e kanë vizituar dhe i kanë dhënë
13 vetëm formularë për të plotësuar. Ndërkohë që nuk i kanë
14 afruar asnjë lloj ndihme. Të shkosh e të shikosh, të vizitosh
15 një person të sëmurë në burg dhe t'i japësh atij vetëm
16 formularë për t'u plotësuar, formularë që janë nga 28 faqe të
17 gjata, është diçka tërësisht e pa -- është diçka që nuk
18 ndihmon fare. Është komplet e pashpresë. Po flasim për një
19 person i cili nuk mban mend asgjë. Nuk mban mend numrin e vet
20 të identifikimit, nuk mban mend numrin e bankës. Pra, është
21 person që ka probleme të shumta sa i takon vartësisë afatgjatë
22 që është një problem i qenësishëm dhe ju kemi dhënë
23 informacion i nderuar Gjykatës, megjithatë nuk dua që të futem
24 në probleme të tjera shëndetësore që janë konfidenciale, i
25 nderuar Gjykatës, megjithatë në një situatë të tillë të

1 përgjithshëm, si bëhet vlera e pronave, si bëhet vlerësimi i
2 duhur në mënyrë të tillë që të përcaktohet ndihma juridike
3 falas.

4 Unë dhe ai po punojmë për plotësimin e këtyre
5 formularëve. Megjithatë, mua më nevojitet një ekip për ta bërë
6 këtë gjë. Ai më beson mua, ne kemi marrëdhënie të mira, ka
7 disa ditë të mira sepse ka marrë medikamente ndërkohë që ka
8 qenë i ndaluar në paraburgim, por kur ka mbërritur avokati i
9 caktuar kryesisht avokati kujdestar me të cilin unë jam
10 takuar, jam takuar, pra, avokatit është dashur që të shkojë që
11 të takojë z. Bahtijari dhe ai ka qenë tërësisht në izolim për
12 shkak të faktit sepse ai ishte tërësisht sëmurë, ndërkohë që
13 mua vetë më është dashur që t'i çoj një brisk z. Bahtijari.
14 Pra, është një situatë shokuese.

15 Përveç shkurtimeve në shumën e ndihmës juridike falas,
16 Zyra Administrative ka refuzuar që të më caktojë mua si avokat
17 kujdestar.

18 Sugjerimi juaj, i nderuar Gjykatës, pra që të caktohej
19 dikush tjetër në vendin tim për mua kjo është absolutisht jo
20 logjike sepse unë jam Mbrojtëse në të gjithë mund -- pra
21 askush nuk po më paguan mua. Mund të jem unë personi që të
22 shërbej si mbrojtëse kujdestare i z. Bahtijari.

23 Pra, unë kam pyetur, i kam kërkuar Zyrës së Mbrojtjes në
24 qoftë se mund të më caktonin ata mua si avokat Mbrojtës
25 megjithëse nuk më kujtohet data, ndoshta ka qenë data 6 deri 8

1 janar. Pyetja ishte shumë e thjeshtë, thjesht më caktoni mua
2 si avokat kujdestar dhe thashë që ishte mirë që unë të kisha
3 ndihmë në mënyrë të tillë që të bëja plotësimet e nevojshme
4 për ndihmë juridike.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Sa për të qenë të qartë,
6 domethënë e keni fjalën për plotësimin e formularëve në shqip,
7 për këtë e keni fjalën, se nuk e kam të qartë nga ndërhyrja?

8 Pra, ju e keni fjalën që të ndihmoni për plotësimin e
9 formularit në shqip. Pra nuk ishte qëllimi që të zëvendësohej
10 avokati kujdestar, por thjesht të gjendej një mënyrë më e
11 arsyeshme?

12 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po pse të
13 mos të më ndihmoni mua? Pra, për momentin po e bëj unë
14 financimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës. Unë nuk jam
15 paguar që prej janarit e në vijim. Kam kërkuar për financim
16 për Mbrojtësin kujdestar, kam kërkuar për financim urgjent dhe
17 do të thoja që kjo është një situatë unike, është një situatë
18 e cila është e pandeshur më përpara. Pra, rregulli 99 është
19 shumë interesant në këtë situatë dhe për këtë arsye ja u kemi
20 sjellë në vëmendje.

21 Kështu që në një situatë të tillë Zyra Administrative
22 ndërkohë që gjendej -- ndërkohë që i ndaluari gjendej në një
23 situatë të tillë, pra, nuk bëri asgjë, thjesht solli disa
24 formularë për të plotësuar më tej. Kjo nuk të ndihmon.

25 Gjykata më ka vënë në dispozicion një përkthyes. Pra, do

1 të dërgoj -- më është dashur domethënë që të dërgoja një email
2 dhe emaili i parë që mu dërgua ishte që nuk -- ju vëmë në
3 dispozicion përkthyesin, por ndërkohë thashë që kemi të drejtë
4 që të përkthehemi kështu që pas mu vu në dispozicion një
5 përkthyes. Ne kemi bërë hetime në terren në Kosovë. Dhe
6 përgjigja që kemi marrë është që mund të përdorni familjet
7 domethënë anëtarët e familjeve, familjarët në mënyrë të tillë
8 që të ndihmohemi për të bërë hetimet përkatëse. Por, kjo
9 kërkon kohë, dhe koha në vetvete do të çojë në shtyrjen e
10 gjykimit.

11 Pra, Gjykata po mbulon të gjitha shpenzimet për çdo
12 person tjetër, ndërkohë që neve nuk po ndihmohemi siç duhet.
13 Jam besimplotë që të plotësojmë formularin si në versionin
14 shqip ashtu dhe në anglisht që do të plotësohet nga z.
15 Bahtijari dhe unë me aq sa të mundemi në më të mira të
16 njohurive tona ato nuk do të jenë të mjaftueshme për Zyrën
17 Administrative sepse duhen bërë hetime dhe kërkime në terren
18 në Kosovë.

19 Ministria e Drejtësisë i ka dhënë shtetasit të vet që iu
20 kanë shërbyer për vite të tëra me radhë, ata persona të cilët
21 nuk janë akuzuar krime lufte tërësisht të pambështetur. Por,
22 në rastin e klientit tim ai është një baba, është bashkëshort,
23 është punëtor dhe atë e ka lënë tërësisht zbuluar. Zyra
24 Administrative nuk na ka ndihmuar fare vetëm ju i nderuar
25 Gjykatës, mund të na ndihmoni.

1 Por, unë nuk është se do ta lë klientin tim. Por, nga ana
2 tjetër nuk mund të nxjerr para nga xhepi gjatë të gjithë kohës
3 sepse më duhet të paguaj edhe unë faturat e mia. Shpresoj që
4 të mund të na ndihmoni, i nderuar Gjykatës, sepse kjo çfarë ka
5 ndodhur është absolutisht e tmerrshme. Është e tmerrshme për
6 mua, është e tmerrshme për të, është e tmerrshme për
7 bashkëshorten e tij, është e tmerrshme po ashtu edhe për
8 familjen e tij. Të gjithë e dinë që ai është i sëmurë dhe
9 është i pamundur. Kjo është absolutisht shumë e qartë.
10 Prokuroria është treguar mizore, Zyra Administrative është
11 treguar mizore, Ministria e Drejtësisë është treguar po ashtu
12 mizore. I nderuar Gjykatës, keni ju tani mundësinë që të na
13 jepni barazinë e palëve, të na e siguron këtë barazi palësh
14 për të hetuar dhe për të pasur mundësinë që të mund të fitojmë
15 nga ndihma juridike falas.

16 Unë thjesht mund t'ju lutem. Mund t'ju lutem ju, i
17 nderuar Gjykatës, që të gjeni një zgjidhje të drejtë për të më
18 paguar mua për të paguar bashkëmbrojtësin për të paguar një
19 ndihmës ligjor, një ndihmës administrativ, një person
20 mbështetës në mënyrë të tillë që t'i ofrohet ndihma e
21 nevojshëm për një person që i pamundur.

22 Nuk do të diskutoj më për çështjet shëndetësore. Mund të
23 konstatohet që ai mund të jetë i përshtatshëm apo jo për t'u
24 gjykuar. Megjithatë, ai duhet të ketë të drejtë dhe ka të
25 drejtë në fakt që të vlerësohet nga aspekti mjekësor dhe është

1 e rëndësishme që ai të gëzojë të drejtat e veta. Ai ka të
2 drejtë që unë të shoh dosjen e tij mjekësore, gjëra të cilat
3 unë nuk i kam sepse siç e shikoni është e vështirë për mua që
4 të identifikoj se cilat janë problemet e tij shëndetësore,
5 megjithëse unë mund të mundohem dhe të bëj më të mirën time
6 dhe më pas të udhëzohem për ekspertët të gjejmë se cilët janë
7 ekspertët e përshtatshëm dhe të dimë se si të bëhet financimi
8 dhe pastaj të merren të gjitha vendimet përkatëse mbështetur
9 në ekspertizën mjeko-ligjore për sa i takon shëndetësisë së
10 tij. Megjithatë, këto janë të gjitha hapat që kanë nevojë për
11 financim.

12 Situata është absolutisht unike. Është i një llojit të
13 vet. Keni të bëni me një person të sëmure që nuk ka para dhe
14 në një situatë të tillë që Mbrojtja deri tani i ka nxjerrë nga
15 xhepi për të bërë Mbrojtjen e të akuzuarit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, dr. Gerry.

17 Tani do t'i drejtohem z. Cadman

18 Z. CADMAN: [Përkthim] Faleminderit.

19 Nuk do të përsëris atë që thanë kolegët e mi. Do të
20 mundohem të jem sa më i shkurtër. Ajo që e kemi thënë në
21 parashtrimet tona është kjo: Mungesa e financimit ka dhe do të
22 ketë ndikim në mënyrën e përgatitjes së Mbrojtjes së z. Shala,
23 dhe aty e kam bërë të qartë te parashtrimet me shkrim ne kemi
24 detyrimin që ta organizojmë Mbrojtjen e z. Shala në mënyrën më
25 të mirë të mundur.

1 Çdo situatë financiare zgjidhet më herët apo më vonë,
2 shpresojmë në rastin tonë do të zgjidhet më herët.

3 Ju pyetët, i nderuar Gjykatës, se çfarë hapash janë
4 ndërmarrë deri tani. Siç tha z. Rees kërkesa është refuzuar
5 nga Ministria e Drejtësisë. Ekziston detyrim ligjor i
6 Ministrisë së Drejtësisë për të bërë financimin e Mbrojtjes.
7 Udhëzimi administrativ u ndryshua, për mendimin tonë, në
8 mënyrë të papërshtatshme dhe Ministria e Drejtësisë e ka
9 vonuar marrjen e vendimit por ndryshimin e tij udhëzimi
10 administrativ për uljen e financave.

11 Ne kemi bërë apelin. Kemi 30 ditë nga vendimi i ministrit
12 për ta kundërshtuar atë vendim. Me 27 mars është afati për
13 dorëzimin e çdo kundërshtimi ndaj këtij vendimi të ministrit.
14 Dhe Gjykatat në Kosovë do të merren me këtë kërkesë në mënyrë
15 sa më të shpejtë që të jetë e mundur në mënyrë që mos të ketë
16 ndikim në këto procedura këtu.

17 Gjatë kësaj jave kemi bërë edhe kërkesë për financim
18 emergjent. Kam parasysh parashtrimet e z. Nilsson për sa i
19 përket miratimit të financimit në vartësi të vendimit për
20 ndihmë juridike. Ne deri tani nuk kemi marrë një përgjigje
21 adekuate prej Zyrës Administrative as nga Zyra e Mbrojtjes e
22 as nga Administratorja apo Zëvendësadministratori për atë
23 punë.

24 Formularët për ndihmë juridike janë mbushur, janë
25 plotësuar. I kemi mbushur, plotësuar me z. Shala bashkë

1 objektin e paraburgimit, por edhe një herë po e cek se
2 Ministria e Drejtësisë e ka detyrimin e financimit. Ne po
3 kërkojmë përkohësisht një zgjidhje, mirëpo kjo nuk ndikon
4 aspak në afatet që kemi diskutuar më herët në lidhje me
5 transferimin e çështje gjyqësore Trupit Gjykues për gjykim.

6 Z. Shala mbahet në paraburgim tashmë për tre muaj. Nuk
7 duam kjo të ndikojë në afatin për kalimin e çështjes te Trupi
8 Gjykues dhe fillimi i gjykimit. Pra, pavarësisht që nuk është
9 marrë një vendim deri tani, kjo nuk duhet të ndikojë në
10 gjykimin dhe në përparimin, ecjen përpara të çështjes drejt
11 gjykimit. Në qoftë se Zyra Administrative është në gjendje që
12 të na mundësojë një farë fondi emergjent deri në zgjidhje të
13 përkohshme deri në një zgjidhje të mëtejshme afatgjate, kjo
14 mendoj që do të ishte një zgjidhje ideale.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

16 Mbjaj parasysh nga ajo që tha z. Rees, se ju do të
17 kundërshtoni vendimin e Ministrisë së Drejtësisë para
18 Gjykatave në Kosovë, para Gjykatës Administrative në Kosovë.

19 Znj. Gerry -- Dr. Gerry, më falni, a e kundërshtoni edhe
20 ju vendimin administrativ të Ministrisë së Mbrojtjes [Sipas
21 përkthimit] të Kosovës, që ta kemi thjesht në procesverbal.

22 Z. Cadman

23 Z. CADMAN: [Përkthim] Vetëm një gjë desha të shtoj.
24 Kundërshtimi që e ka përmendur z. Rees është në lidhje me një
25 referim Gjykatë Kushtetuese të Dhomave të Specializuara për

1 vendimin e Zyrës Administrative për ndryshimin e ndihmës
2 juridike. Ky është ai kundërshtimi.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E kam të qartë.

4 Znj. Gerry, a do ta kundërshtoni ju atë vendim?

5 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po, ne duhet
6 ta bëjmë atë kundërshtim, mirëpo nuk kam asnjë njeri në
7 Kosovë, ndonjë avokat në Kosovë, që të mund të më ndihmojë me
8 atë çështje.

9 Unë i kam dërguar një email Ministrisë së Drejtësisë.
10 Thjesht kam kërkuar që edhe një herë të bëj rishqyrtimin e
11 vendimit të vet. Kam marrë një përgjigje dhe besoj që kjo do
12 të na çojë te një afat i ri edhe pse unë do të kisha dashur me
13 gjithë dëshirë, pra, të bëj dorëzimin e atij kundërshtimi
14 brenda javës që vjen. Mirëpo, nuk -- për shkak të mungesës së
15 mjeteve nuk kam mundësi që ta bëja brenda atij afati.

16 Si duket nuk kemi ndonjë rrugëdalje tjetër unë e z.
17 Bahtijari në këtë çështje, përveçse të punojmë bashkë edhe të
18 bëjmë më të mirën të mundur vetëm unë e ai.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, dr. Gerry.

20 Tani do t'ia jap fjalën përfaqësuesit të Zyrës
21 Administrative, z. Nilsson, për t'ju përgjigjur parashtimeve
22 të tre ekipeve.

23 Z. NILSSON: [Përkthim] Do të përpiqem që t'i trajtoj
24 çështjet që u ngritën nga avokatët e Mbrojtjes. Fillimisht dua
25 të theksoj se nuk kemi refuzuar asnjëherë që të japim

1 përgjigje dhe ju do të shihni nga kopjet që do t'jua
2 dorëzojmë, i nderuar Gjykatës, të korrespondencës se ne çdo
3 herë kemi qenë të gatshëm të përgjigjemi. Pothuajse çdo ditë
4 jemi në kontakt me ekipet e Mbrojtjes. Nuk kemi refuzuar që të
5 përgjigjemi. Ndoshta avokatëve të Mbrojtjes nuk ju pëlqejnë
6 përgjigjet tona, mirëpo kjo nuk do të thotë se nuk jemi
7 përgjigjur.

8 Për sa i përket komunikimeve nuk mund të them ndonjë gjë
9 tjetër më thelbësore. Kur jemi takuar para gjashtë javësh, ju,
10 të nderuar Gjykatës, parashtruat një pyetje për sa i përket
11 sistemit të ndihmës juridike të DHSK-së, mundësitë që ofron
12 ajo dhe kjo ishte që të bëhen -- që një i akuzuar të bëjë
13 kërkesën për ndihmë juridike dhe për caktimin e një mbrojtësi.
14 Dhe kjo është bërë. Ne në parashtrimet tona dhe në letrat dhe
15 emaillet që i kemi dërguar e kemi bërë të qartë këtë.

16 Kemi arritur një farë progresi. Dëgjova nga avokatja për
17 sa i përket plotësimit të formularëve.

18 Por dua të theksoj se nuk ka pasur shkurtime apo ulje të
19 ndihmës juridike në këtë çështje. Nuk ka pasur shkurtime sepse
20 nuk ka pasur vendim për miratimin e ndihmës juridike në këtë
21 çështje gjyqësore. Nuk mund të them tani në qoftë se të
22 akuzuarve në këtë çështje do t'ju miratohet ndihmë juridike në
23 qoftë se do t'i plotësojnë kushtet për ndihmë juridike dhe
24 kështu me radhë, në bazë të sistemit ligjor, kuadrit të DHSK-
25 së. Nuk mund, pra, të them në qoftë se do t'ju miratohet

1 ndihma, dhe në qoftë se do t'ju miratohet atëherë sa do t'ju
2 miratohet. Këto janë objekt i vendimit të Administratores.
3 Para së gjithashtu, para se të merret një vendim i tillë,
4 bëhet hetim i të mirave materiale dhe gjendjes financiare të
5 personit që e bën kërkesën për ndihmë juridike.

6 Dhe me një fjali mund ta them kështu, nuk jemi afër një
7 vendimi për ndihmë juridike, pa paraqitjen e një kërkesë për
8 një ndihmë të tillë. Përpara se të marrim një kërkesë të
9 tillë, ne nuk mund të dalim me një vendim.

10 E dyta, atë që mund ta them me siguri të plotë është se
11 në qoftë se del në fund një vendim për ndihmë juridike,
12 atëherë ka mundësi ligjore për ta kundërshtuar atë vendim. Ka
13 procedurë që është e përcaktuar me ligj sesi të kundërshtohet
14 një vendim negativ për ndihmë juridike.

15 Dhe ndërkohë nuk kemi kurrfarë detyrimi të nxjerrjes së
16 materialeve. Kur të kemi një vendim për ndihmë juridike
17 atëherë mund të bëhen edhe kundërshtimet.

18 Sa i përket udhëzimeve që i kërkoi ekipi Mbrojtës i
19 Januzit, në qoftë se ata po e ngrenë çështjen përpara Gjykatës
20 Kushtuese të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ai Panel,
21 pra Gjykatës Kushtetuese mund të bëjë kërkesë për t'i dorëzuar
22 parashtrime, pra që Zyra Administrative t'i dorëzojë
23 parashtrime.

24 Mendoj se deri këtu prej meje. Ne kemi dorëzuar disa
25 raporte. Raporti i fundit është dorëzuar dje. Dhe është

1 shpërndarë sot në mëngjes dhe nuk përfshin ndonjë informacion
2 të ri si të thuash, po thjesht mund të shikohen edhe një herë
3 transkriptet e konferencave për ecurinë e çështjes që janë
4 mbajtur në të kaluar do të shihni se ka përputhshmëri
5 informacioni.

6 Ne sa i përket propozimit për caktimin e një ndihmësi që
7 do ta ndihmojë z. Bahtijari në plotësimin e formularëve, siç e
8 din edhe avokatja e tij ne kemi mundësuar që atij t'i vihet në
9 dispozicion një përkthyes për të gjitha vizitat që ka avokaten
10 e vet.

11 Ndihma tjetër është se shefi i Zyrës së Mbrojtjes është
12 takuar me z. Bahtijari më shumë se një herë, të paktën dy
13 herë. Ja ka dorëzuar formularët, i kanë kaluar bashkë
14 formularët për t'ia sqaruar atë që është e nevojshme. Ne dje i
15 ofruam përsëri Mbrojtjes së z. Bahtijari që të shkonin në
16 objektin e paraburgimin dhe për t'i kaluar edhe një herë
17 bashkë formularët.

18 Ka një farë kufiri deri ku mund të shkojë ndihma. Ka
19 informacion që ne nuk e kemi, sigurisht, dhe ky informacion
20 duhet të vijë vetë nga z. Bahtijari apo anëtarët e familjes së
21 tij. Avokatja e z. Bahtijari është në kontakt me anëtarët e
22 familjes së tij. Dhe për sa i përket informacionit se çfarë do
23 të thotë kjo këtu në këtë pjesë formulari, sigurisht që ne atë
24 informacion do ta japim pa kurrfarë problemi.

25 U bënë disa parashtime të tjera. Nuk di në qoftë se i

1 kapa të gjitha, i përfshiva të gjitha në përgjigjen time. Dhe
2 shpresoj që po. Në qoftë se jo, besoj që në parashtrimet me
3 shkrim janë të gjitha përgjigjet edhe pse ndoshta përgjigjet
4 që nuk ju shkojnë për shtat avokatëve të Mbrojtjes.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Nilsson.

6 A ka ZPS-ja parashtrime në lidhje me këtë temë? Nuk ka
7 nevojë të ngriheni në këmbë Prokurore. Nuk ka parashtrime.

8 Nuk e di në qoftë se dikush, ekipet e Mbrojtjes duan të
9 shtojnë ndonjë gjë në lidhje me këtë që u tha.

10 Z. REES: [Përkthim] Injorimi i gjithë asaj që u tha në
11 kërkesë dhe përgjigja duke iu referuar aspekteve që nuk janë
12 aspak relevant për kërkesën nuk është një përgjigje, dhe mund
13 të përshkruhet si refuzim për të trajtimin e kërkesës. Injorim
14 i plotë i kërkesës.

15 Në një mënyrë z. Nilsson iu përgjigj asaj kërkesë për
16 informacion tani sepse ai të paktën tha se pothuajse në mënyrë
17 të guximshme që nuk do të bëhen kurrfarë parashtrimesh prej
18 Zyrës Administrative. Kush, cili organ administrativ apo
19 ekzekutiv vepron në këtë mënyrë? Cili organ administrativ apo
20 ekzekutiv që thotë se i zbaton standardet më të larta
21 ndërkombëtare bën një deklaratë të tillë pa u konsultuar, pa
22 kurrfarë konsultimi thotë: Nuk do të bëjmë kurrfarë nxjerrje
23 materiale, nuk do të japim asnjëfarë informacioni dhe nuk do
24 të japim kurrfarë arsyetimi të vendimit.

25 Z. Nilsson thotë që të bëhet një kërkesë për ndihmë

1 juridike. Për çfarë nevojë, për çfarë vlere? Çfarë ndihme mund
2 të japë një fond i Zyrës Administrative që një organ që vepron
3 si ka dëshirë vetë. I ndryshon rregullat si ka dëshirë vetë,
4 në mënyrë të njëanshme.

5 Z. Nilsson thotë që pozita nuk ka ndryshuar nga
6 Konferenca për Ecurinë e Çështjes e fundit. Kjo nuk ka
7 kurrfarë kuptimi. Përshkrimi i ndryshimeve të skemës, të
8 sistemit të ndihmës juridike thjeshtë ulje me 60 deri 75 për
9 qind e tarifave dhe asgjë tjetër. Si mund të përshkruhet kjo
10 ndryshe z. Nilsson? Si do ta kishit përshkruar ju? Ne këtë nuk
11 do ta dimë asnjëherë se z. Nilsson thotë se nuk do të bëhen
12 nxjerrje informacioni, nuk do të angazhohen në një farë
13 dialogu dhe nuk do të japin kurrfarë arsyetimi.

14 Unë, sikurse thashë më përpara, i nderuar Gjykatës, Zyra
15 Administrative nuk është e interesuar të ndër marrë hapa
16 konstruktivë për zgjidhjen e kësaj çështje. Thjeshtë thotë: Na
17 çoni në gjyq, dhe aty jemi dhe atë do ta bëjmë. Do të bëjmë
18 një kërkesë referuese para Gjykatës Kushtetuese dhe do të
19 kërkojmë prej tyre që të bëhet urdhër për nxjerrje
20 informacioni sepse ju, i nderuar Gjykatës, nuk keni atë
21 kompetencë. Mirëpo, si duket Zyra Administrative e sheh
22 vetveten se është mbi ju dhe juridiksionin tuaj, i nderuar
23 Gjykatës.

24 Si Gjykatës i Procedurës Paraprake, ju keni si kompetencë
25 që të siguronit që të gjitha përgatitjes për gjykim të kryhen

1 në mënyrë të drejtë, të shpejtë dhe siç duhet. Dhe ju mund të
2 jepni vetëm udhëzime, i nderuar Gjykatës, dhe mund ta
3 urdhëroni Zyrën Administrative për t'i bërë një dorëzim të
4 tillë informacionit dhe ta shohim se çfarë do të ndodhë mbas
5 asaj. Por në qoftë se palët këtu dëshirojnë të arrihet një
6 farë përparimi, Zyra Administrative duhet ta bëjë atë nxjerrje
7 informacioni përpara se ne të bëjmë dorëzimin e parashtimeve
8 tona dhe të shohim se ku do të mbërrijmë më pas.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

10 Dr. Gerry.

11 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

12 Shkurtimisht, në qoftë se më lejoni. Ne kontestojmë atë çfarë
13 tha Zyra Administrative, pavarësisht që sugjeron që ne kemi
14 vënë në dispozicion përkthyes. Fillimisht na u refuzua
15 kërkesa, por pastaj na u vu në dispozicion një përkthyes.

16 Së dyti, ata thonë që i janë treguar formularët z.
17 Bahtijari dhe që Zyra Administrative ka kaluar me të këto
18 pikat e ndryshme në formular. Por, ne nuk e kemi plotësuar
19 atë. Pra, po ashtu Zyra Administrative thotë që e kemi çuar që
20 të vizitohet nga një mjek dhe që të marrë të gjithë formularët
21 e tjerë të cilët i nevojiten.

22 Ndërkohë, ajo çfarë ju them unë, i nderuar Gjykatës,
23 është që unë ja kam dërguar formularët atij, por, ndërkohë ja
24 kam dërguar por ai a qenë me dhimbje ngaqë është i sëmurë. Dhe
25 unë kam vazhdar punën time megjithatë Zyra Administrative

1 paguhen për punën e tyre. Ata paguhen që të shkojnë në burg
2 dhe që të dorëzojnë ca formularë. Dhe kaq punë bëjnë, asgjë
3 tjerët, ndërkohë që unë vazhdoj të punoj pa u paguar fare.

4 Kur kam pyetur se çfarë sistemi keni për të financuar
5 këdo që nuk është i aftë që të plotësojë formularë, për
6 shembull, për çështje shëndetësore, përgjigja që kam marrë ka
7 qenë zero. Pra, nuk kishte asnjë sistem, siç duket të paktën
8 kështu më ka thënë Zyra Administrative që nuk ka absolutisht
9 asnjë lloj sistemi për të ndihmuar dikë që ka ndonjë -- për
10 hetime në terren për të plotësuar formularët për ndihmë
11 juridike falas. Për mua kjo më duhet padrejtësi. Kjo më duhet
12 mungesë barazie ndërmjet palëve. Dhe në qoftë se do të
13 shprehem me gjuhën e Gjykatës është abuzim i procedurës
14 gjyqësore.

15 Përsëri po vazhdoj që ju kërkoj, po ju lutem, i nderuar
16 Gjykatës, që të na ndihmoni së bashku me anëtarët e tjerë të
17 ekipit në mënyrë të tillë që të sigurohemi që hetimet do të
18 kryhen plotësisht, ndërkohë që unë do të vazhdoj dhe do të
19 shërbej si avokate e klientit tim. Zyra Administrative
20 ndërkohë nuk ka ndihmuar fare dhe nuk ka bërë asgjë.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Gerry, ju thatë që
22 keni që të ndihmoheni nga dikush në terren. Kur ja u thashë
23 këtë gjë më herët, më thatë jo.

24 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Jo, unë nuk
25 thashë këtë gjë.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ndoshta nuk jemi kuptuar.
2 Dhe unë ju pyeta pak më herët, ju thashë, në qoftë se keni
3 kërkuar ndihmën e dikujt në terren në mënyrë të tillë që të
4 mund të ndihmojë për plotësimin e formularit. Tani po më thoni
5 komplet tjetër gjë.

6 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Nuk kam
7 nevojë për ndihmë për sa i takon plotësimin të formularëve. Po
8 i plotësojmë vetë. Nuk e di në qoftë se keni parë ndonjëherë
9 formularët, i nderuar Gjykatës. Domethënë, janë 28 faqe që
10 duhen plotësuar.

11 Për shembull, disa prej pyetjeve janë: Si quhet fëmijët?
12 Çfarë pune bëjnë? Kur kanë filluar punën?

13 Pra, prej këtyre pyetjeve nuk mund të marrin përgjigje
14 nga informacioni që ka z. Bahtijari dhe për këtë arsye më
15 duhet që të marr informacion nga persona të tjerë, për
16 shembull, në shtëpinë ku jeton aktualisht z. Bahtijari, e ka
17 të trashëguar nga më përpara apo jo. Ose ka pyetje të kësaj
18 natyre të cilat kanë nevojë për hetime të mëtejshme, ose kanë
19 nevojë për informacione të tjera dhe kanë nevojë për një
20 vlerësim të një personi që është në terren.

21 Po të kisha patur unë një ekip do të ishte shumë e
22 thjeshtë për mua që t'i udhëzoja ata që të shkonin e të
23 merrnin përgjigjet në terren.

24 Është e vërtetë që unë dua që të kem një ndihmë të tillë,
25 por këtë ndihmë duhet ta kem si pjesë të ekipit tim, në mënyrë

1 të tillë që të mund ta përfaqësoj siç duhet z. Bahtijari.

2 Nuk di si ta them ndryshe. Unë duhet të kem mundësi që të
3 kem ekipin dhe pastaj e gjej vetë zgjidhje, e gjej vetë sesi
4 do të mund ta ndihmoj.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra, nëse ju kuptova
6 drejtë, ju po thoni s'keni nevojë për ndihmë për sa i takon
7 plotësimin të formularit. Por, kërkoni ose do të donit të
8 kishit dikënd brenda për brenda ekipit tuaj që mund të ishte
9 në Kosovë edhe të ishte në gjendje që t'ju ndihmonte për
10 dhënien e informacionit të nevojshëm ose për të bërë vlerësime
11 të caktuara për t'ju dhënë informacion e nevojshëm për të
12 plotësuar formularin. A e përmblodha siç duhet këtë që sapo
13 thatë?

14 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po.
15 Megjithatë, më lejoni që të shtoj edhe diçka tjetër. Disa prej
16 këtyre pyetjeve ose hetimeve do të jenë të nevojshme
17 gjithashtu edhe për prova që do të paraqiten Trupit Gjykses
18 ose në procesin gjyqësor. Kështu që hetimet e Mbrojtjes duhet
19 që të ndodhin në të njëjtën kohë. Për këtë arsye, e përmenda
20 edhe më herët, që rregulla 99 është e rëndësishme për ju.

21 Për shembull, në gjykim, mund të vendosë që z. Bahtijari
22 të mund të të tregojë situatën e vet personale, ose ndoshta
23 mund të tregojë ose të shpjegojë sesi sillet në të përditshmen
24 e vet. Dëshmitar

25 Domethënë, me fjalë të tjera, nuk ja vlen që të thuhet që

1 të kemi dikënd në terren thjesht për të na ndihmuar për të
2 plotësuar formularin, por ajo çfarë ka vlerë është që le t'i
3 japim avokates një ekip në mënyrë të tillë që avokatja të mund
4 të përgatisë të gjithë çështjen dhe në mënyrë të tillë që të
5 mund të plotësohet i gjithë informacioni dhe të jepet
6 informacioni i nevojshëm, përfshirë këtu edhe informacionin që
7 duhet për plotësimin e formularit.

8 Ne i kemi plotësuar formularët që deklaroi që ai nuk ka
9 prona dhe nuk ka të ardhura dhe kjo është një deklaratë që z.
10 Bahtijari e ka bërë. Prokuroria e di se ku jeton z. Bahtijari.
11 Kështu që mendoj që situata e këtij të gjori është tërësisht e
12 qartë.

13 Pra, për mua është e rëndësishme që të kem një ekip dhe
14 që të ndihmohem dhe kur them që të ndihmohem nuk e kam për
15 veten time, por e kam për çështjen, madje edhe parashtrimet,
16 për parashtrime që kanë të bëjnë me gjendjen shëndetësore, unë
17 nuk mund të bëj dot asgjë dhe kjo është një situatë e mjerë,
18 është një situatë shumë e padrejtë.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, dr. Gerry.

20 Z. Cadman, keni për të shtuar ndonjë gjë

21 Z. CADMAN: [Përkthim] Më lejoni të shtoj një çështje që
22 është një konstatim i përgjithshëm që nuk është i kufizuar
23 vetëm thjesht me financimin. E kam fjalën për rolin e ekipeve
24 të Mbrojtjes.

25 Dëgjuam disa shqetësime të cilat ndritën në pas situatën

1 kur nuk kemi mbështetje. Ndërkohë që jemi në një situatë të
2 tillë, mbështetja nga Zyra e Mbrojtjes që është për të
3 ndihmuar Mbrojtjen, pra kam përshtypjen që ky është një
4 detyrim për të cilin duhet që të kujtohet herë pas here Zyra e
5 Mbrojtjes.

6 Më lejoni t'ju jap një shembull konkret: Unë personalisht
7 nuk qëndroj këtu në Hagë. Kur të fillojë procesi gjyqësor do
8 të zhvendosem në Hagë. Megjithatë, aktualisht më duhet të
9 shkoj e të vij. Deri tani këto udhëtimet e mia janë financuar
10 prej nesh. Ne na është dashur që të bëjmë një ankesë për
11 zyrtarin, për oficerin e burgut që do të duhet që të jepet me
12 dorë. Por unë vetë nuk e bëj këtë gjë përderisa nuk jetoj
13 këtu. Kam kërkuar ndihmë nga Zyra e Mbrojtjes dhe ndihma u
14 hodh poshtë.

15 Pra, me fjalë të tjera po përpiqem të them që i duhet
16 kujtuar Zyrës së Mbrojtjes se Zyra e Mbrojtjes ekziston që t'i
17 vijë në ndihmë ekipeve të Mbrojtjes. Këtë doja të nxirrja në
18 pah, i nderuar Gjykatës.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

20 Nuk shoh që ndonjë person dëshiron të marri fjalën, apo
21 jo?

22 Z. Nilsson, dëshironi të shtoni diçka?

23 Mund ta merrni fjalën.

24 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

25 Kam disa komente lidhur me atë që sapo u tha. Sa për ta

1 bërë të qartë, sigurisht që ne do i përgjigjemi çdo ankese apo
2 çdo kundërshtimi që ka të bëjë me një vendim për ndihmë
3 juridike falas që do të vijë nga Dhoma e Gjykatës Kushtetuese
4 që mund të jetë një vendim që mund të merret ose jo.
5 Gjithsesi, në të gjitha rastet, si në të gjitha rastet neve do
6 të ndjekim procedurën dhe nuk e kemi problem fare që të
7 përgjigjemi.

8 Mbrotjtja e z. Bahtijari përmendi financimet për
9 plotësimin e formularit ose për aplikimin e ndihmës juridike
10 falas. Nuk ka ndihmë juridike falas për të bërë aplikimin për
11 ndihmë juridike falas, që ta kemi të qartë këtë gjë. Ndoshta
12 edhe po e ngatërrojmë pak këtë sa i takon për vlerësimin e
13 pronave, të pasurive që është një proces i cili do të bëhet
14 nga Zyra Administrative në momentin që të na dorëzohet kërkesa
15 për ndihmë juridike falas. Domethënë, pasi të plotësohen
16 formularët, pasi të na vijnë dokumentet përkatëse neve atëherë
17 ne do të vazhdojmë pjesën e vlerësimit në qoftë se ekzistojnë
18 apo jo nga ana e të akuzuarve prova ose të ardhura përkatëse.

19 Sa i takon komentit të fundit që Zyra e Mbrojtjes duhet
20 të ndihmojë ekipet e Mbrojtjes nuk mendoj se është e nevojshme
21 që të bëhet një kujtesë e tillë sepse ne e dimë këtë gjë.

22 Z. REES: [Përkthim] Z. Rees.

23 Z. REES: [Përkthim] Po përpiqem që të jem sa më
24 konstruktiv të jetë e mundur. A mund ta pyes z. Nilsson në
25 qoftë se ai në emër të Zyrës Administrative do pranonte një

1 kërkesë për ndihmë juridike falas të bërë në këtë fazë pa
2 paragjykim ndaj asnjë referimi për kundërshtimin e -- për
3 kundërshtime të mundshme që mund të ekzistojnë për rregulloret
4 që janë rishikuar nga Dhomat Administrative. Pra, doja t'i
5 kërkoja z. Nilsson që t'i merrnin kërkesat të tilla parasysht
6 duke iu referuar vendimit përkatës të Dhomës Kushtetuese.
7 Domethënë, me fjalë të tjera, dua të pyes z. Nilsson në qoftë
8 se do të pranonte një kërkesë për ndihmë juridike mbi këtë
9 bazë. Domethënë, me fjalë të tjera që të mund të kishim disa
10 fonde në dispozicion për të vazhduar për të kundërshtuar
11 ligjshmërinë e ndryshimeve të cilat janë bërë nga Zyrat
12 Administrative sa i takon aspektit të financimit.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Nilsson, a mund të
14 përgjigjeni?

15 Z. NILSSON: [Përkthim] Në qoftë se marrim një kërkesë për
16 ndihmë juridike falas, do ta trajtojmë atë si çdo kërkesë
17 tjetër. Nuk mendoj që më duhet të pranoj ndonjë gjë dhe ajo
18 çfarë është më e rëndësishme nuk është e nevojshme që z. Rees
19 të marrë një përgjigje pozitive lidhur me këtë pikë prej meje,
20 sepse këtë kërkesë ne do ta trajtojmë si çdo kërkesë tjetër që
21 na vjen në Zyrën Administrative.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Rees, shkurtimisht.

23 Z. REES: [Përkthim] Po, shkurtimisht. Kjo është një
24 përgjigje shumë ligjore nga z. Nilsson. Pra, është një
25 përgjigje ligjore që nuk iu përgjigj fare kërkesës time.

1 Pyetja nuk ishte a do ta trajtojnë apo jo kërkesën, po
2 pyetja ishte që a presin ata që kërkesa të bëhet pa
3 paragjykuar referimin përpara Dhomës Kushtetuese dhe që në
4 qoftë se ato do të pranonin që kërkesa të bëhej pa pranim nga
5 ana e ankimuesit se rregullimet për ndihmë juridike do të
6 rishikohen në qoftë se do të jenë të ligjshme apo jo dhe në
7 qoftë se do të kemi mundësi që tarifat e përcaktuar, pra të
8 bëhet vlerësimi përkatës nga Dhoma Kushtetuese në qoftë se
9 tarifat e rishikuara janë të arsyeshme dhe adekuate. Kjo ishte
10 pyetja, nuk ishte pyetja që pretendoi z. Nilsson që të ishte.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Nilsson, nuk e di në
12 qoftë se doni t'i përgjigje kësaj pyetje apo jo. Kam
13 përshtypjen që nuk dëshiron që t'i përgjigjet, të paktën këtë
14 kuptova nga parashtrimet që bëri. Mund ta pyes përsëri.

15 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Të paktën jam
16 mirënjohës z. Gjykatës sepse do të ishte mirë pra, do të ishte
17 mirë që Zyra Administrative të përfshihej në një dialog, sepse
18 siç thatë edhe juve përgjigja ishte që nuk donin që të
19 përfshiheshin edhe pa e thënë shprehimisht këtë gjë.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Nilsson, keni ndonjë
21 përgjigje për të dhënë?

22 Z. NILSSON: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë për të shtuar.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull.

24 Znj. Gerry, ju lutem.

25 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Z. Nilsson

1 thotë që "Ne mund të bëjmë kërkesa pasi të dorëzojmë
2 formularin", megjithatë, unë them që më mirë që t'i bëjmë këtu
3 pyetjet në mënyrë të tillë që të mos humbim kohë kot.

4 Një shembull i shkurtër është: Në qoftë se unë nuk jap
5 një numër llogarie bankare në formular ata nuk mund që të
6 bëjnë hetimet përkatëse për numrin e llogarisë. Domethënë
7 është thjesht një shembull i vogël për t'ju treguar sesa kohë
8 të duhet edhe sesa nuk mund ta bësh dot punën në qoftë se nuk
9 ke një ekip të plotë.

10 Kështu që nuk -- duhet një herë, pra të merren gjërat hap
11 pas hapin, të merren hallka në mënyrë të tillë që të mund të
12 vijohet pastaj me shqyrtime nga Zyra Administrative.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull.

14 I mbajta shënim parashtrimet e palëve, në veçanti lidhur
15 me apelet pezull ose kundërshtimet gjyqësore në të ardhmen
16 lidhur me këtë çështje përpara Gjykatave Kosovare por,
17 gjithashtu, mundësisht potencialisht edhe këtu përpara Dhomave
18 të Specializuara.

19 Nuk shoh shumë hapësirë për një qasje, nuk di si ta them
20 ndryshe, domethënë nuk më duket sikur ka ndonjë hapësirë për
21 të zgjidhur problemet pa përfunduar përpara organeve gjyqësore
22 përkatëse, dhe kjo çështje me shumë gjasa do të trajtohet
23 përmes parashtrimeve dhe vendimeve me shkrim nga tani e në
24 vijim sepse kjo është mënyra më e mundshme sesi mund të
25 përfundojë kjo gjë.

1 I ftoj të gjithë që të veprojnë sa më shpejt të jetë e
2 mundur lidhur me këtë pikë. I ftoj që të japin informacion sa
3 më shpejt të jetë e mundur në mënyrë të tillë që të mund të
4 vijojmë sa më shpejt për interesin e shpejtësisë të procesit
5 gjyqësore dhe në dobi të të akuzuarve.

6 Tani më lejoni të kaloj tek pika tjetër. Pra, pika e parë
7 që ishte parashikuar në urdhrin për Planifikimin e Seancës që
8 ishte nxjerrja e materialeve.

9 Dëshiroj që t'i jap fjalën Prokurorisë që të na thotë se
10 çfarë progresi është bërë në nxjerrin e materialit provues.
11 Kam mbajtur shënim parashtrimet me shkrim të ZPS-së sa i takon
12 çështjes së nxjerrjes. Lidhur me materialet sipas rregullës
13 102(1)(b) ZPS-ja thotë që ka kërkuar autorizim për nxjerrjen
14 në pajtim me rregullën 102(1)(b) dhe imazhet forenzike të një
15 telefoni të sekuestruar nga z. Haxhi Shala, si dhe ekstraktet
16 e procesverbale përfshirë këtu edhe mesazhet që janë dërguar
17 nga telefoni në fjalë. Unë do t'i referohem ose do të t'i
18 përmend këto materiale nga z. Shala, si telefoni, si
19 "materiale të mëtejshme".

20 Sipas ZPS-së, analiza e telefonit të z. Shala dhe
21 materialeve të lidhura me të nuk është përfunduar deri me 15
22 dhjetor 2023, që ishte afati për nxjerrjen sipas rregullës
23 102(1)(b).

24 ZPS-ja gjithashtu thotë që materialet të mëtejshme janë
25 të kufizuara, lidhen me materialin relevant që është provues

1 për akuzuar dhe nxjerrja e menjëhershme e tyre nuk mund të
2 bëhet tani por do të bëhet në momentin më të përshtatshëm për
3 përballjen e Mbrojtjes.

4 E di që Mbrojtja e Shalës i është përgjigjur kërkesës me
5 parashtrimet me shkrim të datës 19 shkurt 2024 dhe ka
6 kundërshtuar kërkesën e ZPS-së. Në të thuhet që materialet që
7 synon ZPS-ja të nxjerrë nuk e arrijnë pragun e relevancës
8 *prima facie* dhe se mbajtja e këtyre informacioneve dhe
9 telefonit të z. Shala e vendos në vështirësi të akuzuarin.

10 Do e ftoja ZPS-në dhe Mbrojtjen e z. Shala që të bëjë
11 plotësimet e parashtrimeve me shkrim në qoftë se dëshirojnë,
12 dhe unë do të vendos lidhur me këtë kërkesë me një vendim
13 gojor në fund të Konferencës për Ecurinë e Çështjes.

14 Sa i takon rregullës 102(3) vërej se materiali provues
15 është nxjerrë me përjashtim të një dokumenti që ka të bëjë me
16 rëndësinë materiale. I informoj palëve që do të vendos lidhur
17 me këtë përmes një vendimi me shkrim.

18 Vërej gjithashtu që ZPS-ja ka thënë që parashikon që të
19 dorëzojë kërkesa të mëtejshme për autorizimin për të paraqitur
20 dokumentacion plotësues në pajtim me rregullën 102(3). Do i
21 kërkoj ZPS-së që të japë arsyet dhe afatin kohor të kërkesave
22 të tilla dhe këto do të kenë ndikime mbi kalendarin e
23 nxjerrës.

24 Së fundi, ZPS-ja nuk parashikon që të bëjë kërkesa sipas
25 rregullës 107 dhe thotë se është në rrugën e duhur për të

1 përfunduar nxjerrjen përpara procesit gjyqësor jo më vonë sesa
2 ditën e premte, datë 12 prill 2024. Dhe një herë dua që ta
3 pyes ZPS-në sesi është e mundur kjo për aq kohë sa nuk kemi
4 një listë të përditësuar sipas rregullit 102(3).

5 Mbrojtja e Januzit thotë që nxjerrjet nuk janë
6 përfunduar. Më tej vëren se me datë 14 mars 2024, Prokuroria
7 ka dhënë njoftim për synimin e saj për të hequr redaktime
8 standarde për materiale sipas rregullës -- në dokumentin
9 116599-TR dhe ka thënë që do të nxjerrë versionin e
10 paredaktuar sa më shpejt të jetë e mundur. Megjithatë, sipas
11 Mbrojtjes kjo nuk është bërë akoma.

12 Ftoj ZPS-në që të japë parashtrime lidhur me këtë pikë
13 dhe të na thotë në qoftë se kjo është bërë si pjesë e paketave
14 më të fundit të nxjerrjes të materialeve që u shpërndanë dje.

15 Mbrojtja e Bahtijarit ka bërë të ditur se ka kërkuar
16 dokumente për shëndetin e të akuzuarit pranë ZPS-së.

17 Kështu që i ftoj palët që të bëjnë parashtrime në lidhje
18 me këto tema në përgjithësi.

19 Do të filloj me Zyrën e Prokurorisë.

20 ZNJ. SHAHBUDDIN: [Përkthim] Do të filloj, i nderuar
21 Gjykatës, me si të thuash thelbin e të gjithave këtyre
22 kërkesave dhe parashtrimeve që janë edhe kërkesat për
23 materiale shtesë dhe për nxjerrjen e materialit.

24 Nxjerrjet e mëtejshme të materialeve që kanë të bëjnë me
25 masat hetimore të autorizuara të kohëve të fundit do të

1 nxirren dhe ne do t'i identifikojmë, evidentojmë ato dokumente
2 në kohën e duhur. Ne do t'i bëjmë kërkesat përkatëse në lidhje
3 me ato dokumente sipas rregullës 102(1)(b) ose në qoftë se
4 materiali bie në kuadër të një rregulle tjetër, atëherë
5 kërkesat për masa Mbrojtëse do t'i bëjmë sipas rregullës
6 102(3).

7 Nuk e kemi ndërmend të kërkojmë autorizim për dorëzimin e
8 një njoftimi shtesë sipas rregullës 102(3) duke parasysh
9 detyrimin në vazhdimësi që kemi për vlerësimin e materialeve
10 që vijnë në ndërkohë dhe njoftimin e palës tjetër në lidhje me
11 to.

12 Për sa i përket parashtrimin që ka bërë ZPS-ja në lidhje
13 me analizat forenzike këto analiza janë në zhvillim e sipër
14 dhe materiali në lidhje me to duhet të dorëzohet deri me 12
15 prill 2024.

16 Sa e di unë materiali është kufizuar. Procesi tashmë ka
17 filluar dhe në qoftë se këto nxjerrje materialelesh do të bëhen
18 në kohën e duhur pa thënë një datë të caktuar se kur do të
19 bëhet nxjerrja e atyre materialeve duke patur parasysh se
20 duhet në disa raste autorizim për nxjerrjen prej palës që ka
21 dhënë informacionin.

22 Sa i përket materialeve që ka evidentuar Mbrojtja e z.
23 Januzi këto nxjerrje materialelesh janë si vijon: Materialet nuk
24 janë me më pak redaktime, jemi të gatshëm të punojmë bashkë me
25 kolegët tonë që këto materiale të dorëzohen. Tashmë janë

1 dorëzuar paketat me materiale 19, 20 dhe 21.

2 Sa i përket kërkesave të rregullës 102(3) të avokatit të
3 z. Bahtijari dhe kërkesa që kanë të bëjnë me gjendjen
4 shëndetësore sikurse i kemi bërë të ditur edhe vetë avokatit
5 në kontaktet ndërmjet palëve, Zyra e Prokurorisë i ka dhënë të
6 gjitha informacionet e duhura dhe ka drejtuar Mbrojtësen e z.
7 Bahtijari tek një dokument përkatës që është shtojcë e një
8 parashtrimi të Prokurorisë. Për mendimin tonë, me kaq
9 përfundon hetimi sa i përket Prokurorisë.

10 Ne kemi marrë edhe një kërkesë tjetër që lidhet me
11 materialet e rregullës 102(3). Jemi në proces të rishikimit të
12 asaj kërkesë dhe ne do t'ia bëjmë të ditur palëve gjatë
13 kontakteve që kemi *inter partes* me ta kur të përfundojmë me
14 vlerësimet e tilla.

15 Këto ishin parashtrimet e Prokurorisë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

17 Tani fjalën e ka Mbrojtja. Do të fillojmë me z. Rees.

18 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] I nderuar
19 Gjykatës, kërkoj që të urdhërohet ZPS-ja që të përfundojë
20 hetimet forenzike. T'i jepet një datë përfundimi e atyre
21 hetimeve dhe t'i nxjerrë të gjitha dokumentet, provat që ka në
22 bazë të rregullës 102(1)(b) ose 102(3) dhe/ose 103.

23 ZPS-ja gjatë konferencave të mëparshme ka bërë të ditur
24 se çfarë pune ka kryer deri në mbajtjen e atyre konferencave
25 dhe kështu, mirëpo unë mendoj që kjo nuk mund të vazhdojë pa

1 kufi dhe ju duhet t'i caktoni një datë Prokurorisë për
2 përfundimin e atyre hetimeve.

3 Por hetimet në lidhje me pajisjet, me telefonat tani po
4 zgjasin shumë dhe nuk na ka thënë Prokuroria se kur e ka
5 ndërmend të përfundojë me atë hetim. Edhe kjo -- edhe në
6 lidhje me këtë duhet të caktohet një datë e synuar për
7 përfundimin e hetimeve.

8 Ne gjithashtu duhet të bëjmë hetimin forenzik të
9 telefonit mobil të dëshmitarit 1 dhe të partnerit të tij në
10 kohën që vjen. Neve do të na duhet [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR].

12 [REDAKTUAR]

13 Ne do të kërkojmë prova, dëshmi prej eksperti në lidhje
14 me këtë çështje dhe për momentin po përpiqem të gjej një
15 ekspert që do të veprojë *pro bono* meqë nuk kemi financim dhe
16 as Ministria e Drejtësisë e as Zyra Administrative nuk ka
17 ofruar financat që do të na mundësojë angazhimin e një
18 eksperti për hetimin e këtyre pajisjeve. Por këto janë punë që
19 duhet të bëhen, të kryhen.

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR].

24 Dhe prandaj unë ju kërkoj, i nderuar Gjykatës, që të
25 vendosni një farë pike, një farë afati punës së ZPS-së në

1 mënyrë që ta dimë edhe ne që mund të fillojmë dhe të vazhdojmë
2 me hetimet tona, në bazë të asaj që na paraqitet prej
3 Prokurorisë.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Znj. Gerry, do t'jua jap fjalën. Këtë po e them thjesht
6 për të mos e harruar. Ju mund të na jepni një farë kalendari
7 apo datat se kur prisni që të përfundoni me hetimet sepse kur
8 thoni "në kohën që vjen" e kështu me radhë nuk kam unë ndonjë
9 farë pasqyre të qartë kur është kjo. Pra, mbas një jave, mbas
10 një muaji, mbas tre muajsh dhe kështu me radhë. Prandaj na
11 jepni një farë kohëzgjatje të përafërt më të saktë.

12 Znj. Gerry, urdhëroni.

13 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Nuk -- nuk e
14 kam ditur se kaq shumë mund të ketë ndikim -- mund të kem
15 ndikim sa ju të harroni, i nderuar Gjykatës.

16 Pajtohem me ju, që -- dhe me z. Rees që Prokurorisë duhet
17 t'i caktohet një datë për të përfunduar hetimet.

18 Mendoj që data aktuale 22 prill është data kur duhet ne
19 të përgjigjemi. Shpresoj që kjo datë të mund të shtyhet deri
20 në fund të majit për Mbrojtjen. Ne kemi kërkuar përgjigje nga
21 Prokuroria dhe jemi si të thuash kemi dyshime të mëdha për sa
22 i përket përgjigjeve që kanë të bëjnë me çështjet e shëndetit.

23 Çështje të tjera i kemi trajtuar me email, pra jemi në
24 komunikim e sipër me Prokurorinë. Thjesht të shohin se çfarë
25 përgjigje në fund do të marrin.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Urdhëroni z. Cadman, ju e
2 keni fjalën

3 Z. CADMAN: [Përkthim] Z. Rees ngriti pikat që desha t'i
4 përmendja dhe unë. Unë i bashkohem kërkesës së z. Rees dhe ne
5 kemi të drejtë që të bëjmë hetimin e atyre pajisjeve, të kemi
6 qasje në urdhrat që janë zbatuar dhe janë miratuar dhe përveç
7 kësaj ka edhe shqetësime të tjera, por nuk do t'i përmend këtu
8 meqë duhet të kalojmë në seancë private. Mirëpo, ka shqetësime
9 sa i përket integritetit të informacionit që paraqitet.

10 Kërkesa të tjera kanë të bëjnë me regjistrimet me audio
11 të këtyre intervistave. Ka disa çështje që dua t'i hetoj më
12 tej dhe këtë mund ta bëjmë mbasi t'i kemi ato incizime. Ju siç
13 e dini, i nderuar Gjykatës, ZPS-ja regjistron incizon të
14 gjitha intervistat, kështu që nuk shohim ne ndonjë arsye se
15 pse nuk mund të jepen ato materiale me redaktimet përkatëse.

16 Për sa i përket materialeve të nxjerra me paketat 19, 20
17 dhe 21, këto janë materiale që shkojnë dikun në maj të vitit
18 të kaluar. Domethënë lidhen me atë datë dhe parashtrohet
19 pyetja se pse nuk janë dorëzuar më herët. Këto materiale na
20 është dashtë të na jepen shumë ma herët dhe gjithë ky proces i
21 nxjerrjes së materialeve duhet të efikas dhe më i shpejtë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

23 Znj. Prokurore, në qoftë se keni përgjigje në lidhje me
24 këto parashtime të Mbrojtjes, urdhëroni.

25 ZNJ. SHAHBUDDIN: [Përkthim] Do të përpiqem që të flas në

1 mënyrë më të përgjithshme në mënyrë që të mbetemi në seancë të
2 hapur të mos kalojmë në seancë private.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk ka nevojë të jeni
4 kriptikë me datat. Mund t'i thoni lirisht datat.

5 ZNJ. SHAHBUDDIN: [Përkthim] Rezultatet nga hapat e
6 ndërmarrë në bazë të vendimit tuaj, i nderuar Gjykatës, KSC-
7 BC-2023-10/F151 dhe KSC-BC-2023-10/F184, ato hapa janë
8 ndërmarrë. Dhe materiali që kemi marrë është duke u përpunuar
9 dhe analizuar për parë relevancën e atij materiali.

10 Për sa i përket vendimit F151 presim autorizimin tuaj për
11 nxjerrjen e një materiali që del nga ai proces së bashku me
12 një raport në lidhje me metadatat dhe me regjistrimet dhe
13 transkriptet përkatëse. Këto janë materialet që i kanë
14 përmendur avokatët e z. Januzi dhe z. Shala si materiale që
15 duan t'i shikojnë.

16 Ne nuk i kemi marrë këto materiale nga partnerët që kanë
17 bërë analizën forenzike mirëpo e dimë që materiali do të na
18 vijë dhe siç kam thënë ka një version i prillit 2023 që tashmë
19 i është dorëzuar Mbrojtjes së të gjithë të akuzuarve.

20 Në lidhje me vendimin 184 të Gjykatësit kemi marrë disa
21 dokumente, të dhëna të cilat po procesohen, përpunohen,
22 rishikohen, vlerësohen dhe besoj që në bazë të kësaj do të
23 jetë të gatshme për nxjerrje mbas një kohe shumë të shkurtër.
24 Kur them kohe të shkurtër e kam fjalë për maksimum dy javë.

25 Për sa i përket vendimit KSC-BC-2023-10/F155, që është

1 referenca për telefonat e konfiskuar ju takojnë të akuzuarve,
2 z. Januzi dhe Bahtijari do të them se fotografitë e nxjerrja
3 këtyre telefonave gjatë analizës forenzike po analizohen dhe
4 përmbajtja e atyre do të jetë e gatshme për t'ju nxjerrë
5 Mbrojtjes brenda dy javëve në vijim. Dhe këto përmbajtje do të
6 jenë të plota në mënyrë që Mbrojtja të ketë qasje në të gjitha
7 materialet që i dëshiron.

8 Për sa i përket heqjes së redaktimeve që ka bërë ZPS-ja
9 kohëve të fundit në seancë publike mund të them që
10 informacioni që paraprakisht ishte redaktuar në bazë të
11 kërkesës që ZPS-ja i bëri Gjykatës dhe arsyet që miratuan ato
12 redaktime nuk ekziston më dhe ne si Prokurori po i marrim të
13 gjitha masat që të hiqen të gjitha redaktimet dhe aktivisht
14 mundohemi që t'i vëmë Mbrojtjes në dispozicion sa më shumë
15 informacion që është e mundur për të përgatitur mbrojtjet e
16 klientëve të tyre.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
18 Prokurore.

19 Tani do t'i pyes përkthyesit në qoftë se mund të
20 vazhdojmë edhe disa minuta përpara se të kalojmë në pushim.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani do të kalojmë tek pika
22 tjetër e rendit të ditës që është statusi i hetimeve të ZPS-
23 së.

24 Rikujtoj se ZPS-ja ka dorëzuar dosjen paraprake dhe
25 tabelën sipas rregullës 109(c).

1 Në parashtrimin e fundit ZPS-ja ka bërë të ditur se ka
2 arritur një progres të konsiderueshëm në hetimin që po
3 vazhdon, porse kanë mbetur disa hapa të tjerë për t'u marrë.
4 Në këtë moment ZPS-ja nuk mendon që hapat hetimore do të
5 përfundojnë para datës 28 mars 2024. Ftoj ZPS-në që të na japë
6 një pasqyrë të kalendarit apo të orareve të ZPS-së në lidhje
7 me këtë.

8 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

9 ZNJ. SHAHBUDDIN: [Përkthim] Po, data 28 mars është javën
10 që vjen. Ndërkohë na kanë ardhë shumë materiale dhe na duhet
11 më shumë kohë për t'i përpunuar ato dhe për t'i bërë të
12 gatshme për nxjerrje.

13 Prandaj mendoj që të na zgjatet afati deri me datën 12
14 prill në qoftë se është mundur.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ka dallim midis materialit,
16 procesimit të materialit që e keni në dispozicion dhe
17 materialit që do të vijë në të ardhmen. Pra, ky është
18 shqetësimi im në lidhje me datat.

19 ZNJ. SHAHBUDDIN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne
20 merremi me situata që lidhen me fakte që kanë çuar edhe në
21 ndjekjen penale të kësaj çështje. Kështu ne nuk i kufizojmë
22 ato mundësi në qoftë se do të ketë ndonjë ndryshim se
23 sigurisht që këto ndryshime do t'ja bëjmë të ditur Mbrojtjes,
24 por për momentin nuk parashikohen ndryshime të tilla.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

1 A kanë ekipet Mbrojtëse ndonjë gjë për të shtuar në këtë?

2 PËRKTHYESJA: Mbrojtja "jo".

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Falënderoj përkthyesit që
4 na dhanë edhe një kohë për të përfunduar këtë temë dhe do të
5 vazhdojmë mbas 15 minutave pushim.

6 --- Pauza fillon në orën 16.11

7 --- Seanca rifillon në orën 16.28

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Për pikën e radhës në
9 rendin e ditës dua t'i drejtohem së pari Mbrojtjes. Të
10 dëgjojmë pikësëpari parashtrimet e Mbrojtjes lidhur me -- duke
11 pasur parasysh informacionin që dha ZPS-ja. Së pari, për sa i
12 përket ecurisë së hetimeve të Mbrojtjes; synimi për të dhënë
13 njoftim për alibi ose shkaqe për përjashtimin e përgjegjësisë
14 penale; ndonjë synim për të bërë kërkesa që kanë të bëjnë me
15 mundësitë hetimore; dhe në qoftë se Mbrojtja synon që dorëzojë
16 një dosje paragjyqësore sipas rregullës 95(5).

17 Tani do t'ju jap fjalën ju, ekipeve të Mbrojtjes duke
18 filluar nga z. Rees.

19 Z. Rees, fjala për ju.

20 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Qëndrimin tonë
21 e kemi parashtruar me shkrim në përgjigje të urdhrin tuaj, i
22 nderuar Gjykatës, sa i takon parashtrimeve. Dhe nuk është se
23 kam dëgjuar asgjë të re as nga ZPS-ja as nga Zyra
24 Administrative që do të çonin në ndryshimin e parashtrimeve që
25 kam dorëzuar. Kështu që në qoftë se do të kemi ndonjë zhvillim

1 të ri, përsëri parashtimet do t'i bëjmë me shkrim.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] faleminderit, z. Rees.

3 Dr. Gerry.

4 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Edhe ne çdo
5 gjë e kemi parashtruar me shkrim.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. Cadman, fjala për ju,

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Qëndrimi ynë mbetet po ai që kemi
9 parashtruar në dokumentacionin me shkrim të dorëzuar. Sa i
10 takon hetimeve të Mbrojtjes këto hetime janë në vijim e sipër.
11 Ne synojmë që të dorëzojmë një dosje para gjykimit.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

13 Prokuroria dëshiron që të bëjë ndonjë parashtrim?

14 Në rregull, vazhdojmë më tej. Do të kalojmë tek pikat për
15 pajtim për çështje juridike dhe çështje faktike.

16 Vërej që me datë 5 shkurt 2024, ZPS-ja ka qarkulluar për
17 të gjithë të akuzuarit përmes postës elektronike një listë të
18 fakteve për të cilat palët pajtohen. Vërej nga parashtrimet me
19 shkrim që nuk ka pajtim ndërmjet palëve dhe si zakonisht
20 dëshiroj që t'i kujtoj palëve që nuk ekziston detyrimi për t'u
21 pajtuar për çështje faktike dhe juridike përpara gjykimit.

22 Nuk është e nevojshme që të diskutojmë për këtë çështje
23 tani me përjashtim të rasteve kur Mbrojtjet duan që të japin
24 ndonjë parashtrim plotësues lidhur me këtë pikë. Nuk e di në
25 qoftë se doni të thoni ndonjë gjë. Z. Cadman.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Kam folur me ZPS-në gjatë pushimit.
2 Ne jemi duke u përgatitur për t'u përgjigjur për faktet për të
3 cilat palët pajtohen dhe do kemi diskutimet në kohën e duhur
4 me ZPS-në për sa i takon pikave juridike për të cilat biem
5 dakord me ta.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit z.
7 Cadman.

8 Ndërkohë askush nga palët e tjera nuk kërkon që të marrë
9 fjalën.

10 Tani të kalojmë te pika tjetër në rendin e ditës që ka të
11 bëjë me transferimin e dosjes së çështjes përpara Trupit
12 Gjykues dhe ku janë gati palët që të fillojë gjykimi.

13 Në Urdhrin për Caktimin e Datës, ju kërkoja palëve që të
14 jepnin parashtrimet e tyre sa i takon përgatitjes dhe sa të
15 aftë janë ata që të fillojnë gjykimet. Ky është diçka që u
16 kërkuva që të mund të parashtronin palët deri të premtën me
17 datë 31 maj 2024. Parashtrimet me shkrim janë marrë por
18 ndërkohë u tha nga Mbrojtja që ishte e pamundur ky afat të
19 ishte i arritshme për të shkak të situatës së financimit.

20 Le të vazhdojmë që dëgjojmë palët sa i takon kësaj pike.

21 ZNJ. SHAHBUDDIN: [Përkthim] Qëndrimi ynë është i njëjtë
22 me atë që është parashtruar në dokumentacionin e dorëzuar. Nuk
23 mund të flasim për këtë çështje por sa i takon Prokurorisë ne
24 nuk kemi ndonjë problem për të qenë gati në datën që
25 propozohet nga ju, i nderuar Gjykatës.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

2 Z. Rees, juve?

3 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Ne e kemi
4 parashtruar me shumë qartësi pozicionin tonë në parashtrimet
5 me shkrim. Nuk është se kemi dëgjuar ndonjë gjë të re nga ZPS-
6 ja dhe më e rëndësishme as nga Zyra Administrative që do të
7 çonte në ndryshimin e qëndrimit tonë. E vetmja gjë që mund të
8 them është që afatet e përcaktuar janë optimiste.

9 Megjithatë, kjo është ajo çfarë kam thënë edhe sa i takon
10 afateve të vlerësuara për mua dhe që janë dorëzuar në
11 Konferencën e katërt për Ecurinë e Çështjes. Dhe qëndrimi nuk
12 ka ndryshuar as sot në Konferencën e pestë për Ecurinë e
13 Çështjes. Në qoftë se ka ndonjë gjë tjetër më konkrete për të
14 cilën do të doni përgjigjen time më thoni.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

16 Znj. Gerry.

17 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Parashtrimet
18 e mia janë të njëjta. Kjo është një datë që është shumë
19 optimiste duke marrë parasysh në veçanti gjendjen shëndetësore
20 të z. Bahtijari. Aq më tepër që Prokuroria sot nuk ka tha në
21 qoftë se do të kishte mundësi që të trajtojë dokumentacionin
22 që parashikohet në sesionin 102, 103 deri më datë 12 prill.
23 Mua mu duk sikur tha që afati do të shtyhej për më tepër sesa
24 kaq. Domethënë do të kishte mundësi që të dorëzonte dokumentet
25 sipas rregullës 103 dhe 103 përtej datës 12 prill.

1 Nuk është praktike që të përgjigjemi dhe me përjashtim të
2 rasteve kur Ministria e Drejtësisë të përshpejtojë dhe të japë
3 financime në qoftë se domethënë Ministria e Drejtësisë
4 financime javën që vjen, nuk është e mundur që të mund të jemi
5 gati për procesin gjyqësor në fund të majit.

6 Pa diskutim që klienti im dëshiron që ky gjykim të
7 trajtohet sa më shpejt që të jetë e mundur, megjithatë kjo
8 duhet të bëhet në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë të ndjeshme
9 pa e vendosur Mbrojtjen nën trysni të mëtejshme të
10 panevojshme. E di që mbase mund t'ju duket se ky është një
11 sulm i koordinuar nga Mbrojtja, por nga ana tjetër ne kemi
12 probleme me Prokurorinë, kemi probleme me Zyrën Administrative
13 dhe Ministrinë e Drejtësisë. Pra, nuk do të jetë me vend që
14 Mbrojtja të vendoset nën trysni që të kalojmë çështjen për
15 gjykim në një moment kur klienti im nuk është i përshtatshëm
16 për t'iu nënshtruar gjykimit.

17 Kjo nuk do të thotë që nuk do të vazhdojmë të punojmë
18 shumë sepse besoj që i dëgjuam edhe sot sesa -- dhe Zyra
19 Administrative ju tha juve sesa kohë kam kaluar me z.
20 Bahtijari që është treguese. Ne po punojmë sa më shumë të jetë
21 e mundur, por ndërkohë që Zyra Administrative duhet të më japë
22 financime, bën numërimin e orëve që unë punoj me z. Bahtijari.
23 Megjithatë, ne do të vazhdojmë të punojmë fort deri në
24 konferencën e radhës për ecurinë e çështjes dhe pastaj deri
25 atëherë besoj që mund të diskutojmë pak më tepër lidhur me

1 këtë pikë.

2 Mbase në një prej konferencave të radhës për ecurinë e
3 çështjes mund të diskutojmë në më tepër objektivitet lidhur me
4 këtë pikë.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

6 Z. Cadman

7 Z. CADMAN: [Përkthim] Në parashtrimet tona ne i kemi
8 dhënë parashikimet tona megjithatë është e parakohshme që të
9 përcaktojmë datën kur të mund të kalojë çështja për gjykim.
10 Kemi gjëra të tjera të cilat do të duhet të shtjellohen. Kemi
11 shqetësime të tjera si për shembull data në të cilat do të
12 nxirren informacionet ose materialet.

13 Në këtë pikë nuk e themi dot këtë gjë. Ne mendojmë që nuk
14 duhet të veprohet me shpejtësi të panevojshme dhe nuk -- pra,
15 duhet që të merren gjërat ashtu siç duhet, por pa diskutim që
16 z. Shala vazhdon dhe i qëndron pozicionit ose qëndrimit të vet
17 që nuk duhet të ketë shtyrje të papërligjur të procesit
18 gjyqësor.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

20 Nuk shikoj që Prokurorja dëshiron të thotë gjë.

21 Tani dua që t'ju kërkoj palëve dhe Zyrës Administrative
22 të më thoni në qoftë se kanë ndonjë çështje tjetër që
23 dëshirojnë të ngrenë gjatë ditës së sotme.

24 ZPS-ja, nuk shoh që doni ta merrni fjalën. Nga Mbrojtja?

25 Z. Rees, jo.

1 Dr. Gerry.

2 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Sa i takon
3 vlerësimin mjekësor të z. Bahtijari kam përshtypjen që juve më
4 ftuat që të bëj një kërkesë në qoftë se është e nevojshme
5 përpara Trupit Gjykses. A mund të reflektoj lidhur me këtë?
6 Nuk di a mund ta shtjelloj këtu tani apo jo. Nuk e di
7 domethënë nuk e di në qoftë se po më urdhëron që ta bëj një
8 vlerësim të tillë. Nuk është se po e anashkaloj ftesën, por
9 sigurisht që unë jam e interesuar që të siguroj raport,
10 vlerësime të pavarura.

11 Pra, dua t'ju kërkoj në qoftë se më lejoni që t'ju jap
12 një përditësim lidhur me vlerësimin e gjendjes shëndetësore të
13 z. Bahtijarit në të njëjtën kohë kur t'ju jap informacion për
14 situatën e financimit, pra t'ju bëj përditësim pas një jave.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull. Në qoftë se më
16 kërkoni që të urdhëroj lidhur me vlerësimin mjekësor apo në
17 qoftë se doni thjesht që të jepni informacion konkret, thjesht
18 sa për të caktuar një profesionist ose një mjek i cili është
19 kualifikuar për ta bërë këtë gjë.

20 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Shpresoj që
21 në emër të z. Bahtijari, në mënyrë të pavarur të mund të
22 gjejmë një mjek ose një ekspert mjekësor në mënyrë të tillë që
23 të bëjmë vlerësime. Unë e kam dhënë pëlqimin për nxjerrjen e
24 gjendjes shëndetësore të tij para një muaji, por ndoshta
25 formulari duhet që të shkojë nga njëra dorë tek tjera.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rastin e gjendjes
2 shëndetësore formulari duhet që të nënshkruhet nga personi i
3 akuzuar.

4 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po,
5 absolutisht po, por nga ana tjetër unë nuk jam e mundur që t'i
6 jap ndihmë dhe kam përshtypjen që ai ka nevojë për mbështetje
7 për ta bërë këtë gjë. Ndonjëherë ka ditë të mira dhe mund të
8 nënshkruajë formularë dhe ndonjëherë jo. Por të paktën në
9 qoftë se dikush mund të m'i japë formularët mund të përpiqem
10 që ta ndihmoj.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit,
12 znj. Gerry.

13 Z. Cadman, kërkuat që të merrnit fjalën.

14 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, dua të ngre një
15 çështje e cila është në parashtrimet me shkrim që ka të bëjë
16 gjithashtu me çështjen e përkthimit.

17 Ky është një diskutim të cilin e kemi bërë edhe më
18 përpara me ju, i nderuar Gjykatës. Megjithatë, dua që të
19 ritheksoj edhe një herë që z. Shala duhet të ketë qasje në të
20 gjitha materialet, por çështja e përkthimit në këtë Gjykatë
21 nuk e lejon një qytetar të Kosovës, një të akuzuar që të ketë
22 qasje në dokumente që janë në një gjuhë që ai e kupton.
23 Domethënë i gjithë dokumentacioni do të duhet që të
24 përkthehet.

25 Pra, thjesht dua që të theksoj edhe një herë që kjo nuk

1 është gjykatë ndërkombëtare, është gjykatë e Kosovës dhe të
2 gjithë dokumentacioni duhet t'i vihet në dispozicion z. Shala
3 në shqip. E di çfarë përgjigje do të kemi prej jush, por
4 thjesht dëshiroj që t'jua sjellë atë në vëmendje.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përderisa e dini se cila do
6 të jetë përgjigja ime, mund ta kundërshtoni vendimin tim sipas
7 kuadrit ligjor të DHSK-së. Nuk shikoj ndonjë palë tjetër që
8 dëshiron që të marrë fjalën.

9 Përpara sesa ta mbyllim për sot kam disa urdhra gojorë.

10 Përpara sesa të jap urdhrin e parë gojor më lejoni të
11 them që kam mbajtur shënim njoftimin e ZPS-së sa i takon
12 heqjes së redaktimeve që janë kundërshtuar nga Mbrojtja e z.
13 Januzi dhe Mbrojtja e z. Shala në kërkesat e tyre me numrat
14 përkatës F00197 dhe F00211, përkatësisht është parashtrimi i
15 protokolluar F00214 në të dhënat për Çështjen 10,
16 dokumentacioni për Çështjen 10 dhe në parashtrimet gojore sot.
17 Pra, kërkesat në këtë pikë janë tejkaluar.

18 Tani më lejoni të vazhdoj me urdhrat gojorë.

19 Vërej se kërkesat nga Mbrojtja e Z. Januzi dhe Mbrojtja e
20 z. Shala me numrat F00197 dhe F00211 përmbajnë referenca të
21 materialeve provuese. Si rezultat urdhëroj Mbrojtjen e z.
22 Januzi dhe Mbrojtjen e z. Shala të dorëzojnë versione publike
23 të redaktuara të kërkesave të tyre përkatëse me numrat F00197
24 dhe F00211, të dyja aktualisht janë të klasifikuara si
25 konfidenciale.

1 Këto dorëzime do të duhet të bëhen jo më vonë sesa të
2 enjten datë 28 mars 2023.

3 Kjo përfundon urdhrin tim të parë gojor.

4 Tani dëshiroj që të vazhdoj më tej me kërkesën për
5 riklasifikim nga ZPS-ja në parashtrimin e protokolluar F00217.

6 Përpara se ta bëj këtë gjë, rikujtoj që kam urdhëruar
7 riklasifikimin si publik dhe/ose konfidencial sipas rastit të
8 parashtrimeve të caktuara të protokolluara të enjten me datë
9 21 mars 2024.

10 Lidhur me parashtrimin e protokolluar F00139 në
11 materialet e Çështjes 10 dhe F00026 në materialet e Çështjes
12 11 pas shqyrtimit të parashtrimeve të ZPS-së konstatoj se
13 klasifikimi aktual do të mbahet deri në një urdhër të
14 mëpasshëm.

15 Për më tepër, urdhëroj ZPS-së që ose të kërkojë
16 riklasifikimin si publik ose të dorëzojë një version të
17 redaktuar publik të parashtrimit të protokolluar F00217.

18 Më tej, duke vënë re transferimin e parashtrimeve të
19 protokolluara nga materialet e dosjes hetimore në materialet e
20 çështjes 10 urdhëroj ZPS-në që ose të kërkojë riklasifikimin
21 ose të dorëzojë versionet e redaktuara konfidenciale të
22 parashtrimeve të protokolluar F00204, F00206 dhe F00208,
23 aktualisht të klasifikuara si rreptësisht konfidenciale dhe
24 *ex parte* jo më vonë sesa të mëkurën, datë 27 mars 2024.

25 Kjo përfundon urdhrin tim të dytë gojor.

1 Tani le të vazhdojmë me një tjetër çështje që ka të bëjë
2 me një riklasifikim që buron nga vendimi me numër F00183.
3 Lidhur me këtë do të nxjerr një urdhër të tretë gojor.

4 Pasi kam shqyrtuar parashtrimet e Mbrojtjes së z. Januzi
5 në parashtrimin e protokolluar F00188 dhe të ZPS-së në
6 parashtrimin e protokolluar F00191 konstatoj se procesi që ka
7 të bëjë me parashtrimet F00106, F00115, F00125, F00135 dhe
8 F00183 [Sipas përkthimit] do të vazhdojnë të jenë konfidencial
9 deri sa të jap një tjetër urdhër me gojë.

10 Vazhdoj me urdhrin e katërt gojarisht.

11 Vërej se Mbrojtja për z. Shala ka dorëzuar një kërkesë me
12 numrin F00223 si konfidenciale por nuk jep arsytet se pse ka
13 bërë një klasifikim të tillë. Dëshiroj që palëve t'ju kujtoj
14 në këtë aspekt parimin e publicitetit për procedurat, siç
15 parashikohet në nenin 21(2) dhe 39(6) të Ligjit. Më tej i
16 kujtoj palëve që në pajtim me rregullën 82(3) të Rregullores
17 çdo parashtrim i klasifikuar si konfidencial ose rreptësishtë
18 konfidencial duhet të japë arsytet për këtë lloj klasifikimi
19 dhe në qoftë se dhe kur mund të riklasifikohet.

20 Tani mund të kaloj në urdhrin e katërt gojor.

21 Mbrojtja e z. Shala udhëzohet që ose të kërkojë me shkrim
22 riklasifikimin e parashtrimit të vet me F00223 ose të
23 specifikojë arsytet për ruajtjen e klasifikimit aktual në
24 pajtim me rregullën 82(3) të Rregullores dhe të dorëzojë një
25 version publik të redaktuar të të njëjtit material.

1 Ky është fundi i urdhrin të katërt gojor.

2 Së fundi, do të vazhdoj me urdhrin e pestë gojor që ka të
3 bëjë me kërkesën e ZPS-së për autorizimin e nxjerrjes -- e
4 shtyrjes së nxjerrjes të materialit provues sipas rregullit
5 102(b) (1) që mban numrin F00164.

6 Konstatova paraprakisht që kërkesa e ZPS-së përmbush
7 aspektet procedurale që janë përcaktuar në Vendimin Kuadër për
8 nxjerrjen e materialeve për Çështjen 10 me numër F00763
9 përkatësit paragrafët 44 dhe 45; dhe për Vendimin Kuadër për
10 nxjerrjen e materialeve për Çështjen 11 me numrin F00023,
11 përkatësisht paragrafët 44 dhe 45.

12 Për më tepër kam shqyrtuar parashtrimet me gojë të ditës
13 së sotme si dhe parashtrimin me shkrim të ZPS-së dhe Mbrojtjes
14 së z. Shala në parashtrimet me numër F00164, F00179 dhe
15 F00187.

16 I kam kushtuar vëmendje në veçanti parashtrimin të ZPS-së
17 lidhur me arsyen për shtyrjen e nxjerrjes, që përkatësisht
18 analiza e materialit nuk është përfunduar me 15 dhjetor 2023.

19 Jam bindur më tej përmes parashtrimeve të ZPS-së sa i
20 takon relevancës *prima face* të materialeve në diskutim.

21 Duke marrë parasysh sa më sipër konstatoj që është
22 treguar arsye bindëse që përlligj shtyrjen e nxjerrjes së
23 materialit provues shtesë sipas rregullës 102(b) (1).

24 Për më tepër, vlerësoj në këtë fazë të procedurës që nuk
25 cenohet Mbrojtja përmes shtyrjes së afatit për nxjerrjen e

1 materialeve.

2 Për rrjedhojë miratoj kërkesën e ZPS-së për sa i takon
3 dokumentit me numër F00164 dhe autorizoj ZPS-në që të nxjerrë
4 materialet shtesë provuese në pajtim me rregullin 102(1)(b) të
5 Rregullores.

6 Ky është fundi i urdhrin të pestë gojor dhe është fundi i
7 kësaj Konference të pestë për Ecurinë e Çështjes.

8 Falënderoj palët, përkthyesit, personelin e sigurisë.

9 Dhe këtu e mbyll seancën për sot.

10 --- Seanca mbyllet në orën 16.48

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25